

PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



Viti VI. Nr. 50. 19 janar - 19 shkurt 2011. Organi i Shoqatës Kulturore "Zëri Ynë"

Çmimi 0.80€



Tryezë e rrumbullakët me temë:

Shqiptarët si faktor stabiliteti në rajon

Hotel Grand, Prishtinë,
28 dhjetor 2010

Intervistë me dr. Nazmi Maliqi

**MALIQI: SHQIPTARËT PO
LUAJNË ROLIN E NJË KOMBI
LIDER NË BALLKAN**

Intervistë me mr. Xhavit Shala

**KOSOVA DHE SHQIPËRIA MUND
TË BASHKOHEN, KËTË UA LEJON
KUSHTETUTA SHQIPTARE**






Intervistë me prof. dr. Zymer Neziri

**EPOSI I KRESHNIKËVE,
IDENTITET KULTUROR
I SHQIPTARËVE**

Intervistë me dr. Milazim Krasniqin

**ZBEHJA E IDENTITETIT PRODHON
PAFUQI DHE (AUTO)DESTRUKSION**







10 Vepra, e jo vetëm fjalë!



12 Shqiptarët s'patën fat që...



25 Bosnja dhe Hercegovina...



34 Identiteti i vetmisë poetike



39 Vëllezërit Klitschko nuk e...

Portreti i muajit: Dha dorëheqje 2

Avni Avdiu: Survejimi 3

Drita Vitia: Mësimdhënësit i kthehen bankave shkollore..... 4

Sead Ujkani: Problemet mbesin evidente, viti 2011 shpresë për ndryshim!5-6

Lulzim Ahmeti: Rritja e pagave, 100 milionë euro në vit 7-8

Isa Mehmeti: Fiktivja dhe konkretja 9

Astrit Veliqi: Vepra, e jo vetëm fjalë! 10

Fatos Rushiti: Fillon zbatimi i ligjit për duhanin. 11

Muhamet Jahiri: Shqiptarët s'patën fat që kishin fqinj sllavët e grekët..... 12-13

Intervistë me dr. Milazim Krasniqi..... 14-17

Intervistë me Nazmi Maliqi..... 18-19

Intervistë me Xhavit Shala 20-21

Muhamed J. Kajolli: Shqiptarët – stabilizues apo destabilizues në rajon? 22-23

Ma. Flamur Hyseni: Për çfarë politikanë ka nevojë Kosova? 24-25

Milazim Mustafa: Bosnja dhe Hercegovina, mes halleve dhe shpresës 25-27

Arsim Jonuzi: Në Sudan referendum, në Tunizi dhe Algjeri trazira 27-28

Kastriot Dervishi: Viti kur Ahmet Zogu ndaloj fexhenë 29-31

John L. Esposito: Pse njerëzit e medieve e kanë shumë gabim për Islamin dhe cili është çmimi?... 32

Mr. Gzonit Salihaj: Alkooli etilik (Etanoli) 33

Flamur Maloku: Identiteti i vetmisë poetike . 34-35

Intervistë me prof. dr. Zymer Neziri..... 36-38

Alban Bilalli: Vëllezërit Klitschko nuk e lënë t'i "mbyllë sytë" 39

Alban Bilalli: Barcelona transferoi edhe një futbolist musliman 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti VI / Nr. 50

19 janar - 19 shkurt 2011

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Avni AVDIU
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!



Porterti i muajit

DHA DORËHEQJE

Emisioni investigativ “Fiks Fare” në “Top Channel”, ka transmetuar një filmim ku si protagonistë janë numri dy i qeverisë shqiptare, Ilir Meta dhe ish-ministër i partisë së tij Dritan Prifti. Në këtë filmim i cili mban datën 1 mars 2010, zv.kryeministri Meta, i kërkon vartësit të tij në parti, Priftit, favore klienteliste, që nisin që nga futja në punë e njerëzve të afërt, e deri në favorizimin në tenderët me fondet publike, duke përfshirë edhe hidrocentralet. Pamjet e transmetuara nga “Fiks Fare” zbulojnë hapur korrupsionin në nivelet më të larta të shtetit shqiptar. Publikimi i skandalit të korrupsionit në majën e kupolës së qeverisë shqiptare ka tronditur opinionin publik. Një numër politikadhe i madh në shpërfaqësuesishtë shoqërisë civile kanë reaguar, duke e cilësuar ngjarjen si një dëshmi të rëndë për qeverinë, por edhe për ven-

din. Në emisionin ‘Opinion’ të televizionit Klan të Blendi Fevziut, i ftuari Fatos Lubonja e cilësoi këtë incizim të tmerrshëm që pasqyron korrupsionin në instancat më të larta shtetërore, kurse i ftuari tjetër Artur Zheji shfaqti rezervat e tij për mundësitë e trukimit. Në reagimin e tij të parë Meta u shpreh se i ka shkruar letër kryeparlamentares Jozefina Topalli përmes së cilës dorëzon imunitetin e tij dhe kërkon nga prokuroria hetim të menjëhershëm të këtij rasti, të cilin ai e quajti montazh nga studiot private të Edi Ramës dhe bluf politik të klikës së korrupsionit dhe kimit të organizuar. Incizimi sipas tij është keqpërdorur si është nënshtruar dhe i shtruar taturës e Partisë Socialiste. Kjo ngjarje pritet të tëndosë edhe më thellë gjendjen e brishtë politike në mes pozitës dhe opozitës në Shqipëri.



BIOGRAFIA:

Ilir Meta lindi më 24 mars të vitit 1969 në Skrapar. U diplomua për Ekonomi Politike në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës. Ka përfunduar studimet pasuniversitare në të njëjtën fushë. Që prej 15 viteve është deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe një nga figurat kryesore politike shqiptare. Gjatë viti 1990 ishte pjesëmarrës aktiv në lëvizjen studentore që përmbysi regjimin komunist. Nga viti 1992 në vazhdim, Ilir Meta është zgjedhur pa ndërprerje deputet në të gjitha legjislaturat e Kuvendit të Shqipërisë, në të cilin ka qenë anëtar i disa komisioneve. Gjatë periudhës 1997-1998, Ilir Meta ka qenë Kryetar i Partisë Socialiste të Tiranës. Në periudhën 1993 -1996, ka mbajtur postin e nënkryetarit të Partisë Socialiste dhe nga 1994 - 1996 edhe atë të sekretarit për marrëdhëniet ndërkombëtare. Ka qenë zëvendëskryeministër dhe ministër i koordinimit qeveritar (tetor 1998 - tetor 1999), si dhe sekretar shteti për integrimin evropian në Ministrinë e Punëve të Jashtme (mars - tetor 1998). Ka shërbyer si kryeministër i vendit (nëntor 1999 - shtator 2001) dhe pas fitores së zgjedhjeve parlamentare të verës së vitit 2001 u rimandatua si kryeministër (shtator 2001 - shkurt 2002). Në shkurt 2002, për të shmangur krizën brenda maxhorancës politike dhe qeverisëse dha dorëheqjen nga detyra. Gjithashtu, Meta ka shërbyer edhe si zëvendëskryeministër dhe ministër i punëve të jashtme (korrik 2002 - korrik 2003). Përveç aktivitetit politik, Meta ka dhënë leksione në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, si dhe në disa akademi dhe universitete në Evropë dhe SHBA, si Akademia Evropiane e Berlinit ose Universiteti i Harvardit. Pas zgjedhjeve të fundit parlamentare Meta, kryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim – LSI lidhi koalicion me Sali Berishën, duke marrë postin zëvendëskryeministër dhe ministër i punëve të jashtme. Aktualisht është zëvendëskryeministër dhe ministër i ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Është i martuar me Monika Kryemadhin dhe kanë tre fëmijë: Borën, Besarin dhe Erën.

SURVEJIMI

Avni AVDIU

Në teatrin e madh të politikës shqiptare ku shfaqet drama, komedia dhe tragjedia e përditshme, pasqyrohet piktura reale e lojës së partive dhe politikanëve. Është kjo lojë që s'i shihet dot fundi. Protagonistët ose aktorët e kësaj loje, të cilët janë seriozë vetëm një herë në katër vite (atëherë kur kërkojnë votën), shfrytëzojnë skenën për të demonstruar lloj-lloj marifetllëqe të paskrupullta. Të tillët, porsa të fitojnë, bëhen të pakapshëm, prepotentë që 'fluturojnë' me xhipa të blinduar, skutha që performojnë për mrekulli përpara kamerave, por të cilët nuk gjejnë një minutë kohë të zbrisin te populli për t'ua qarë hallin, ashtu siç zbrisnin gjatë fushatës elektorale. Nga ana tjetër, humbësit bëhen engjëj, e stigmatizojnë fituesin si e keqja e vetme e shoqërisë dhe janë të vetmit që qajnë hallin për gjendjen e mjerë të popullatës së rëndomtë, gjë që u shërben më shumë si kapital politik për fitimin e poenave. Është kjo psikodrama dhe sociodrama demokratike e partive, të cilat periudhën e gjatë të tranzicionit shqiptar e shfrytëzojnë si muaj mjalti për të kamufluar veprimtaritë e tyre të papërgjegjshme. Në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me persona që s'njohin fe e atdhe, pra të cilët nuk ia kanë frikën as Zotit e as popullit. Mu për këtë, ata bëjnë çmos - çfarë t'u vijë në kut.

Mirëpo teknologjia e re e sofistikuuar e përgjimit ka bërë që shumë gjëra më parë të supozuara, tashmë të dalin të

vërteta. Në momentet kur flet zëri dhe fotografia nuk kanë edhe aq punë të zorshme gjykatat dhe prokuroria.

Kohëve të fundit incizimet e fshehta kanë hyrë në modë. Ato janë bërë mjet i denoncimit moral (Ylli Pango) dhe korruptiv (Iliir Meta). Ato tregojnë fytyrën reale të politikanëve, duke i hequr maskat dhe duke zhveshur gëzofin e qengjit në trupat e ujqërve. Përmes incizimeve të tilla populli mund të shoh 'live' prapaskenat e politikës, të hyjë në thelbin e tyre dhe të kuptojë më së miri kulturën e sotme të njerëzve që i përfaqësojnë.

Përndryshe aty ku s'konfiguron as koncepti Zot e popull, i mirëseardhur është syri i kamerës së fshehtë. Ata të cilët s'kanë dert për mbikëqyrjen e Zotit, le të përballen me mbikëqyrjen e kamerave. Ata të cilët nuk kanë ndërgjegje të mbjellë e të kultivuar nga edukata, le t'u imponohet ndërgjegjia shtrënguese e le të skuqen të paktën një herë.

Pa marrë parasysh debatet, se sa e si cenon kjo privatësinë, vlen të thuhet se privatësia individuale bie poshtë në momentet kur prej saj dëmtohet rëndë interesi i përgjithshëm.

Mu për këtë, kjo mënyrë përgjimi ose investigimi është një rrugë shumë efikase për t'i kthyer gjërat për së mbari dhe në binarë të duhur.

E keqja është se për momentin kjo po aplikohet vetëm në Shqipëri, nga një media serioze, kurse e nevojshme është që kjo metodologji të zgjerohet më tej edhe jashtë Shqipërisë në Kosovë, Maqedoni e gjetiu.

Për fat të keq, për momentin, nuk ka shenja në këtë drejtim, prandaj patëm e po kemi aq shumë zhurmë paszgjedhore. Njëherë u pat diskutuar votimi me kamera dhe elektronikë, por më pas u harrua. U harrua, sepse të gjithë e synojnë vjedhjen, të gjithë e duan atë. Problemi që krijohet më pas është se kush ishte më i aftë e kush më pak i aftë që të vidhte. Zgjedhjet e fundit e dëshmuar këtë, pra, se secila parti kishte vjedhur, secila sa ka ditur e sa ka mundur. Po të kishim pasur zgjedhje të mbikëqyrura (me kamera) në Kosovë, nuk do ta kishim gjithë këtë mishmash zgjedhor. As akuzuesit nuk do të kishin pse të lodheshin shumë me fjalë, e as të akuzuarit s'do të mund të gjenin fjalë apologetike. Përderisa kleptomania është shtrirë aq gjerë dhe lufta ndaj saj është bërë e vështirë, pse hezitohet instalimi i kësaj metodologjie?!

Për 'Fiks Fare' ka nevojë edhe në Maqedoni, ku partitë shqiptare në pushtet terrorizojnë psikologjikisht dhe materialisht pjesën tjetër të shqiptarëve që nuk janë me ta. Ato e kanë përmbytur përplot njëzet vite linjën e diskriminimit prej maqedonasve kundër shqiptarëve në diskriminim të shqiptarëve kundër shqiptarëve.

Nuk mjafton vetëm të spekulohet për të zezat e të ligat që ndodhin, por ka nevojë që ato të denoncohen edhe përmes kamerave.

Në këtë kohë kur kanë humbur virtytet më të pastra, që tradicionalisht i ka pasur shqiptari, si nderi, besa, burrëria etj, kur nuk njih kush fe e atdhe, kur paraja, interesi, pozita dhe privilegjet janë mbi gjithçka tjetër, mbikëqyrja me kamera mbetet shpresa e vetme e luftimit të së keqes. ■



MËSIMDHËNËSIT I KTHEHEN BANKAVE SHKOLLORE

Njëmijë mësimitdhënës të parë, të cilët e kanë të mbaruar shkollën e lartë, kanë filluar ligjëratat në Universitetin e Prishtinës ku do të marrin kualifikim shtesë. Një iniciativë e tillë është marrë nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, e mbështetur nga Universiteti i Prishtinës, me qëllim të kualifikimit shtesë të këtyre mësimitdhënësve, pasi që tani arsimtarët në Kosovë marrin paga në bazë të kualifikimit
Drita VITIA

Miradije Halimi është nënë e pesë fëmijëve. Është mësimitdhënëse e gjuhës shqipe në shkollën Filllore "Hasan Prishtina" në Godanc të Shtimes dhe ka 26 vjet përvojë si mësimitdhënëse. Mirëpo, mësuesja pesëdhjetëvjeçare, tani ka nisur një mision të ri. Po ndjek ligjëratat në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, për të marrë kualifikim shtesë dhe për t'u emëruar si profesoreshë. Ajo shprehet e kënaqur sa i përket mundësisë që i ka dhënë Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, pasi, sipas saj, çdo gjë që mësohet është e mirëseardhur deri në fund të jetës. Por, Miradija ka një hall, 'nëse do ta presë shëndoshë e mirë jetësimin e kësaj shkolle'. "Është mirë çdo herë të bëhet një freskim i atyre mësimëve, madje, një ditë na thanë se pas dy vjetësh do të organizojmë përfundimin e studimeve. Por, a do t'i presim ne dy vjet studim, edhe ashtu ne tashmë jemi në moshë dhe po më duket pak e tepërt edhe dy vjet të studiojmë..."-shprehet Miradija me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë.

Studentë nënë e fëmijë

Miradije Halimi, përveçse këtë vit akademik iu ka rikthyer studimeve në UP, ka edhe dy fëmijë të cilët i studiojnë në Fakultetin e Filologjisë në të njëjtin universitet. Mirëpo atë një gjë e tillë nuk e pengon që ta çojë misionin deri në fund. Madje, mësuesja pesëdhjetëvjeçare shprehet se ndonjëherë disa njësi mësimore i përsërit bashkë me fëmijët dhe e ka më të lehtë t'i kuptojë. "Është një freskim në një rënë anë. Është pozitive t'i mësosh edhe një herë ato mësimë sepse i rikujton disa gjëra, edhe pse disa profesorë që na ligjërojnë kanë qenë nxënës tanë. Pastaj kemi edhe ngarkesë sepse jemi familjarë, jemi nëna, prindër dhe çdo gjë varet prej nesh", - thekson Miradija, duke treguar



për vështirësitë që i paraqiten gjatë kësaj periudhe, dhe kjo është arsyeja kryesore, - siç thotë ajo, - e të mos qenit shumë aktive në mësimë. Ndërkohë, edhe Hyrije Buzhdaraj është një nga koleget e Miradijes, e cila këtë vit i ka rifilluar studimet në Universitetin e Prishtinës. Hyrija ka po ashtu pesëdhjetë vjet, prej të cilave dymbëdhjetë përvojë pune si mësimitdhënëse. Ndërkohë, aktualisht është mësimitdhënëse e klasës së nëntë në shkollën Filllore "Pavarësia" në Prishtinë. Hyrija shprehet se shkolla e lartë, të cilën e ka mbaruar, 'për atë kohë ka qenë e mjaftueshme, megjithëse çdo herë ndryshimet janë të mirëseardhura, por për moshën, të cilën e kam nuk e di sa është e nevojshme, edhe pse çdo herë njeriu ka nevojë të mësojë diçka të re', - shprehet Hyrija. Ajo pohon se tani e ka më të vështirë t'i mbajë mend mësimet dhe njësitë mësimore, të cilat ligjërohen sepse, siç tha ajo, me moshë dobësohet edhe kujtesa.

Disa lëndë të panevojshme

Mësueset të cilat tani janë ulur në banka shkollore, jo për të ligjëruar, por kësaj radhe në cilësinë e nxënësve të tyre, pra, për të studiuar, shprehen se ka njësi mësimore, të cilat i dinë 'në gjumë' siç shprehen ato. Por ka edhe disa lëndë, si mësimi për Greqinë antike, të cilat sipas tyre ndoshta nuk do t'u hynë në punë fare. Megjithatë, mësueset kanë vendosur që ta arrijnë cakun, mbarimin e studimeve shtesë. Madje, për këtë ini-

ciativë ato shprehen të kënaqura pasi, pas mbarimit të këtyre dy vjetëve, pagat e tyre do të ngrihen dukshëm.

Studimet financohen nga UP dhe MASHT

Muaj më parë, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj dhe rektori i Universitetit të Prishtinës, Mujë Rugova, nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për kualifikimin e mësimitdhënësve me shkollë të lartë pedagogjike, nga e cila do të përfitojnë rreth 7 mijë mësimitdhënës, të cilët janë nën moshën 50 vjeçare. Këta mësimitdhënës, do të vazhdojnë studimet në Fakultetin e Edukimit (studime 4 vjeçare) dhe me këtë rast, ata do të marrin gradën universitare 'bachelor'. Mësimitdhënësve u është mundësuar që të ndjekin programet e studimit në të katër qendrat e Fakultetit të Edukimit dhe atë gjatë ditëve të vikendit duke filluar nga dita e premte me orar 16:00-20:00 dhe e shtunë 9:00-16:00. Ndërkohë, Universiteti i Prishtinës e ka për obligim që këtyre mësimitdhënësve t'u krijojë kushte për vijimin e procesit mësimor në ligjëratat të cilat ata do t'i ndjekin. Programi i Avancimit dhe Kualifikimit të Mësimitdhënësve është komponenti i katërt i licencimit të mësimitdhënësve. Republika e Kosovës ka 25 mijë mësimitdhënës, nga të cilët 11 mijë janë me shkollë të larta pedagogjike 2 vjeçare dhe 3 vjeçare. ■



PROBLEMET MBESIN EVIDENTE, VITI 2011 SHPRESË PËR NDRYSHIM!

Sead UJKANI

Pritjet e kosovarëve dhe optimizmi i tyre, tashmë disa herë i konfirmuar, për një Kosovë më të mirë, veçanërisht për përmirësim e gjendjes socio-ekonomike dhe, me këtë, edhe të standardit jetësor në vend edhe gjatë vitit që lëmë pas nuk u realizuan.

Vendi vazhdoi të karakterizohet nga një shkallë e lartë varfërie dhe papunësie, nga niveli shqetësues i korrupsionit, nga rritja e ulët e investimeve të huaja, deficit i lartë tregtar etj., parametra këta, të cilët rezultuan me një zhvillim të ulët ekonomik dhe rritje të pakënaqësisë së qytetarëve lidhur me situatën e gjithëmbarshme në vend.

Nëse ndalemi dhe i hedhim një vështrim ngjarjeve, të cilat shënuan vitin 2010, shikuar nga aspekti ekonomik, duke analizuar ndryshimet në parametrat thelbësorë që reflektojnë përmirësimin e situatës socio-ekonomike, atëherë do të konkludojmë që arritjet pozitive në këtë drejtim ishin të pakta.

Trendet e larta të papunësisë dhe varfërisë së skajshme vazhduan edhe gjatë vitit 2010, përderisa nuk kishim ndonjë ndryshim pozitiv në këtë drejtim, duke u mbështetur në vlerësimet që tregojnë nivelin e papunësisë rreth 45 për qind dhe të varfërisë së skajshme rreth 15 për qind.

Rritja ekonomike në vendin tonë u vlerësua të jetë rreth 4.6 për qind, mirëpo një rritje e tillë pati impakt të ulët në praktikë, përkatësisht në përmirësimin e standardit jetësor të qytetarëve të vendit.

Të dhënat që dalin nga bilanci tregtar i Kosovës, rikonfirmojnë edhe njëherë varësinë enorme që kemi nga importi, duke identifikuar

kështu problemin më të madh makroekonomik të vendit tonë. Gjatë vitit të kaluar mbulimi i importit nga eksporti arriti vetëm 13 për qind.

Korrupsioni me përmasa shqetësuese vazhdoi edhe gjatë vitit paraprak, megjithëse i tërë ky vit u karakterizua me deklarime dhe premtime të shumta të zyrtarëve qeveritarë dhe instancave të tjera relevante për luftim dhe parandalim të tij, mirëpo asgjë e re nuk ndodhi. EULEX-i në terren ishte më aktiv në këtë aspekt, mirëpo ende nuk kemi diçka konkrete nga hetimet e ndërmarra nga ana e tyre. Arrestimi i Guvernatorit të Bankës Qendrore mbeti i vetmi element pozitiv në luftën ndaj korrupsionit.

Edhe pse ishte parashikuar që ndërtimi i termocentralit "Kosova C" të fillonte gjatë vitit 2010, kjo gjë nuk ndodhi. Në fillim të vitit të kaluar, Qeveria vendosi të modifikojë kushtet e tenderit për investitorët e mundshëm të këtij projekti, që rezultoi me prolongimin e fillimit të realizimit të tij, që parashihet të nisë gjatë këtij viti dhe të përfundojë në vitin 2016. Ndërsa, gjendja e përgjithshme energjetike në vend nuk kishte ndonjë përmirësim të theksuar. Reduktimet e



energjisë sipas planit ABC edhe këtë vit ishin pjesë e jetesës në vendin tonë.

Ashtu sikurse edhe vitet e kaluara, me një rrjedhë pothuajse të njëjtë, edhe këtë vit vazhdoi procesi i privatizimit. Gjatë shtatë valëve të privatizimit të realizuara gjatë vitit 2010, u krijuan 66 ndërmarrje të reja. Problemet me privatizimin e PTK-së, ngecja në përgatitjen për privatizim të distribuimit të transmisionit elektrik dhe kompleksit turistik "Brezovica", si dhe zvarritjet në realizimin e 20 përqindëshit për punëtorët ishin disa nga dobësitë, të cilat e kanë përcjellë procesin e privatizimit gjatë vitit të kaluar.

Jostabiliteti politik, problemet e gjyqësorit dhe pengesat e ndryshme burokratike, përveç problemeve të lartcekura të energjisë dhe korrupsionit, ishin elemente të tjera të cilat ndikuan në nivelin jo të kënaqshëm të investimeve të huaja në vend. Sipas vlerësimeve të Agjencisë për Promovimin e Investimeve në krahasim me vitin e kaluar, viti 2010 shënoi një rritje prej 3 për qind, që duke marrë parasysh nevojën e zhvillimit ekonomik të vendit, mbetet i ulët.

Një problem tjetër evident edhe gjatë vitit që lamë pas ishte, moskontrollimi adekuat i pikave doganore në veri të vendit, të cilat i sjellin humbje të mëdha buxhetit të vendit si dhe ofrojnë mundësi të mëdha për zhvillimin e kontrabandës dhe si të tilla mbesin sfidë që doemos duhet të zgjidhen në këtë vit në mënyrë që të eliminohen humbjet e mëtutjeshme.

Viti 2010 do të mbahet mend edhe për lëvizjet e shumta të çmimit të

shumta nga qytetarët dhe shprehje të pakënaqësisë së tyre për veprime të tilla nga furrtarët, mirëpo pa ndonjë rezultat pozitiv, sepse në fund të fundit çmimi i bukës u ngrit.

Republika e Kosovës nuk doli mirë as në raportet ndërkombëtare të publikuara fundvitin e kaluar. Në këtë kontekst, Raporti i Progresit, Raporti i Transparency International – Barometri i korrupsionit 2010 dhe Raporti i Bankës Botërore "Të bësh biznes", paraqitën situatën momentale në vend karshi elementeve që flasin raportet në fjalë, si dhe nevojën për angazhim të mirëfilltë për përmirësimin e problemeve të specifikuar në to.

Një hije e keqe padyshim ishin edhe deklarimet tendencioze të potencuara në raportin e Dick Martit, që megjithatë kishte një efekt negativ në imazhin e tërësishëm të vendit tonë në sferën e politikës globale.

Mirëpo më gjithë ngecjet dhe problemet që janë më se evidente dhe shqetësuese, Republika e Kosovës u radhit e treta në Evropë për nga përqindja e rritjes ekonomike, sipas një raporti të publikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Sipas këtij raporti, përqindja e rritjes ekonomike të Kosovës është 4.6 për qind, ndërsa norma mesatare e rritjes është 5.39 për qind.

Viti 2010 shënoi gjithashtu fillimin e punës për ndërtimin e autostradës koncesioni Ndërkombëtar fillimin e protokollit të bizneseve cili me gjithë eliminimin e kontributit fiskal po karakterizohet me një rrjedhë

të ngadalshme dhe pakënaqësi të shumta nga ana e bizneseve.

Por ja që viti 2010 kaloi, mirëpo me këtë nuk kaluan sfidat dhe peripecitë e mëdha që e karakterizojnë zhvillimin ekonomik të vendit. Ekonomia duhet të jetë pashmangshmërisht prioriteti thelbësor në punën e Qeverisë së ardhshme dhe, në këtë kontekst, kërkohet angazhim maksimal nga të gjitha instancat përkatëse në drejtim të përmirësimit të situatës socio-ekonomike në vend dhe standardit të përgjithshëm jetësor në vend.

Vendimi për rritjen e pagave shënoi një fillim të mbarë të vitit 2011, mirëpo ky duhet të jetë vetëm hapi i parë në tërësinë e punëve që duhet të kryhen për të siguruar një trend pozitiv të progresit ekonomik dhe të prosperitetit afatgjatë të vendit tonë.

Shpresojmë në formimin e shpejtë të Qeverisë dhe institucioneve të tjera përkatëse dhe në jetësimin e mirëfilltë të premtimeve të theksuara nga fituesit e zgjedhjeve në vend! ■





RRITJA E PAGAVE, 100 MILIONË EURO NË VIT

Lulzim AHMETI

Premtimi i Hashim Thaçit për rritjen e pagave në fillim të janarit është kthyer në vendim nga Qeveria e Kosovës. Me këtë vendim do të kenë rritje mësimdhënësit parauniversitar për 50 për qind, familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës do të kenë ngritje prej 50 për qind, policia e Kosovës 40 për qind, shërbyesit civilë 30 për qind, zyrtarët doganorë 30 për qind, punëtorët shëndetësorë 30 për qind dhe zjarrfikësit 30 për qind.

Në të njëjtën kohë, edhe minatorët do të kenë ngritje pagash në bazë të një memorandumit të nënshkruar më herët në mes tyre dhe kryeministrit Thaçi. Por rritje nuk do të ketë për pensionistët, paratë e të cilëve nga fondi i tyre i mëhershëm i ka marrë Serbia.

Rritja e pagave, për rreth 75 mijë vetë, do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës 100 milionë euro brenda një viti. Pavarësisht se vendimi duket i pabesueshëm, ai është real. Mirëpo ka skeptikë që thonë se do të jetë vështirë sigurimi i gjithë

këtyre mjeteve për shkak të krizës institucionale dhe mbajtjes së zgjedhjeve meqë ende nuk është miratuar as buxheti në kuvend për këtë vit.

Kryeministri Thaçi dhe zyrtarë të qeverisë shprehen të vendosur për realizimin këtyre rritjeve të prekshme dhe shumë domethënëse për këto kategori të punëtorëve. Ata kanë thënë se do të kursejnë para nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, si dhe do të forcojnë e luftojnë mbledhjen e të hyrave. Por kjo rritje pagash nuk to të kalojë aq lehtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), pasi që qeveria e Kosovës ka nënshkruar një marrëveshje për marrjen e 110 milionë eurove me kushte të volitshme dhe mosrritje të shpenzimeve. Prandaj kjo marrëveshje duhet të rinegociohet prapë. Mund të ketë edhe vështirësi në realizimin e shumë projekteve kapitale, pavarësisht që qeveritarët nuk e pranojnë këtë.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave në largim, Ahmet Shala, ka thënë se vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave do të realizohet nga kursimet në disa ministri.

“Financimi i këtyre rritjeve do të jetë nga kursimet, të cilat nuk do të cenojnë funksionalizimin e shtetit. Kudo dhe në cilëndo ministri që shkoni, në cilëndo komunë që shkoni, ka vend për kursime, sidomos në mallra dhe shërbime. I kemi identifikuar ato edhe gjatë vitit 2010. Kemi identifikuar një përqindje të konsiderueshme, e cila do të jetë në dispozicionin tonë gjatë propozimit të buxhetit për vitin 2011, në parlamentin e ridizajnuar”, - ka treguar Shala.

Barra mbi doganat dhe ATK-në

Ndërkaq, Sekretari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se burimet e financimit të rritjeve të pagave duhet të sigurohen nga zvogëlimi i ekonomisë joformale, evazioni fiskal dhe kursimi në mallra dhe shërbime. “Përderisa është vendim i Qeverisë, atëherë është vendim i plotfuqishëm dhe si i tillë duhet të implementohet. Buxheti shpenzohet aq sa ka të hyra. Nëse arrihet që nga zvogëlimet e ekonomisë joformale dhe evazioni fiskal të sigurohet një pjesë e madhe

e këtyre mjeteve, atëherë nuk rrezikohet buxheti. Mirëpo, duhet një punë shumë e madhe, në mënyrë që të sigurohen mjetet edhe përmes kësaj forme. Pra, të shikohet mundësia e rritjes së buxhetit për 130-150 milionë euro për çdo vit”, - ka thënë Rukiqi. Sipas tij, Qeveria e Kosovës duhet që të rinegociojë me FMN-në, lidhur me vendimin për rritjen e pagave. “Fondi Monetar Ndërkombëtar ka kërkuar që në kuadër të kornizave të këtij buxheti të mos ketë rritje 7 deri në 8 për qind. Mirëpo, nuk e parandalon rritjen e buxhetit me vlerë të përgjithshme. Nëse rritet buxheti në vlerë të përgjithshme diku për 10 për qind, atëherë sigurisht kjo do të duhej të rinegociohej edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar”, - ka thënë Rukiqi.

Qeveria të rinegociojë me FMN-në

Në anën tjetër, Drejtori ekzekutiv i Institutit “Riinvest”, Lumir Abdixhiku, ka thënë se rritja e pagave është e rrezikshme, pasi që është një shumë goxha e mjeteve që duhet të sigurohet. Sipas tij, barra kryesore do t’u bie ATK-së dhe Doganave. “Nëse këto dy institucione nuk do të mund të arrijnë t’i sigurojnë në kohë, ose për shkak të problemeve teknike, do të jetë shumë vështirë që buxheti i Kosovës ta realizojë objektivin e vet”, - ka potencuar Abdixhiku.

Sipas tij, viteve të kaluara, shefi i Doga-

Përfitimet me rritjen e pagave

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave do të përfitojnë:

Mësimdhënësit parauniversitar për 50 për qind.

Familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës do të kenë ngritje prej 50 për qind.

Policia e Kosovës 40 për qind.

Shërbyesit civilë 30 për qind.

Zyrtarët doganorë 30 për qind.

Punëtorët shëndetësorë 30 për qind dhe zjarrfikësit, po ashtu, 30 për qind.

Rritje do të ketë edhe për ministrot dhe punëtorët e drejtësisë.

nës dhe ai i ATK-së kanë deklaruar në vazhdimësi se objektivat kanë qenë përtej kapaciteteve të tyre, e që sipas tij, nëse këto objektiva rriten edhe më tutje rrezikohet realizimi i të hyrave. “Një rast i tillë mund të rrezikojë buxhetin me një deficit tregtar, të cilin mund ta mbulojmë nëpërmjet shitjeve të asetëve nacionale, ose hyrjen në borxhe të reja”, - ka vlerësuar ai.

Por, sipas Abdixhikut, vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave bie ndesh me kontratën aktuale, të cilën Kosova e ka me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Sipas tij, në kontratë thuhet se nuk mund të ketë rritje të

pagave pa rritje të të hyrave. “Në qoftë se ne në njërin anë kemi krijuar obligime dhe në anën tjetër kemi mbetur pa alternativë në të hyra, ne do të duhet t’i shesim të gjitha asetet nacionale me ngut, për t’iu shmangur deficitit. Nëse nuk e bëjmë një gjë të tillë, Fondi Monetar Ndërkombëtar do të fillojë sanksionet financiare ndaj vendit tonë, ose ndalesën e ndihmave financiare, që i kanë premtuar gjatë vitit 2010, e që kapin shuma mjaft të mëdha”, - është shprehur Abdixhiku.

Kurse Musa Limani, ligjërues në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (UP), ka thënë se qeveria në dorëheqje, sipas Kushtetutës së Kosovës, nuk ka drejtë të marrë kurrfarë vendimesh, prandaj një vendim i tillë për ngritje pagash nuk është valid. Sipas tij, pa u aprovuar buxheti për vitin 2011, nuk dihet vlera e mjeteve buxhetore, si dhe nuk dihet destinimi i këtyre mjeteve pa pasur para vetes projektbuxhetin. “Rritja parciale e pagave, siç ka premtuar kryeministri, nuk është në rregull, por sipas tij, duhet të bëhet një analizë komplekse mbi nivelin e pagave në raport me nivelin e çmimeve. Nëse pagat rriten pa u rritur prodhimtaria, atëherë edhe më tutje do të thellohet kriza ekonomike dhe do të bjerë standardi jetësor”, - ka thënë eksperti i ekonomisë Musa Limani. ■



Fiktivja dhe konkretja



Isa MEHMETI

Për ta hetuar se në botë, në veçanti në Evropë, ka më tepër opinion antishqiptar se sa mendohet, nuk duhet shumë logjikë e as filozofi. Mjafton të krahasohet raporti shumë i përfolur i Dik Martit me një studim të Universitetit të Janinës, i botuar në revistën prestigjioze amerikane "The Atlantik". I pari është raport i shpifur, pa asnjë argument të ofruar dhe i dyti është real dhe faktik. Raporti i shpifur veçse ishte antishqiptar bëri bujë të madhe ndërkombëtare, saqë pati edhe reagime kontraverse diplomatike. Raporti tjetër, në të cilin viktimë janë shqiptarët, kalon në heshtje dhe pakkush e di. Në të vërtetë, raporti i fundit i Universitetit të Janinës, i botuar në revistën prestigjioze amerikane "The Atlantik", ka shokuar opinionin publik, teksa zbulohen abuzimet e mjekëve grekë me shëndetin e emigrantëve shqiptarë në gjashtë spitale të shtetit fqinjë. Skandali i publikuar nga revista tregon për operacionet e jashtëligjshme të heqjes së apendicitit te pacientët shqiptarë. Sipas revistës, në vitin 2001, në spitalet greke qarkullonin fjalë se kirurgët, për të rritur numrin e operacioneve, u diagnostikuan apendicitë të paqenë emigrantëve shqiptarë. Në Universitetin Mjekësor të Janinës, një mjekje e sapodiplomuar, e quajtur Athina Tatsioni, i kishte dëgjuar dhe diskutuar thashethemet me kolegët, kur një profesor i dëgjuar, Xhon Joanidis,

i kërkoi të përpiquej që ta vërtetonte të vërtetën. E reja e pranoi sfidën dhe, me ndihmën e profesorit dhe kolegëve të tjerë kreu një studim zyrtar ku tregohet se apendicitët e hequr nga pacientët me emrat shqiptarë në gjashtë spitale greke ishin më shumë se tre herë më të shëndoshë se ato që iu hiqeshin pacientëve me emra grekë. "Ishte e vështirë për të gjetur një ditari të gatshëm për ta publikuar më pas atë, por ne e bëmë", - kujton Tatsioni. "Unë gjithashtu zbulova se hulumtimi ishte i vërtetë. Profesi që udhëhoqi studimin, së bashku me një ekip dhe personel jashtëzakonisht profesional, të rinj dhe kureshtarë, punuan për rezultatet e studimit të gjerë ku u panë me imtësi të dhënat si edhe kartelat ku ishte shkruar për rastet e operacioneve. Studimi tregoi se kirurgët grekë rrisnin numrin e operacioneve, duke abuzuar me pacientët shqiptarë dhe profesionin, për të marrë rroga dhe përqindje më të majme. Mjekja Tatsioni tanimë bën pjesë në grupin e kërkuesve shkencorë të profesorit të njohur Xhon Joanidis, i cili e nxiti të verifikonte overdozën e operacioneve për heqjen e apendicitit ndaj pacientëve shqiptarë, duke vërtetuar se ndërhyrjet nuk janë bërë konform rregullave mjekësore, si dhe ligjeve mbi bazën e të cilave operohet në praktikë.

Raport i saktë dhe i vërtetë kalon totalisht në heshtje, pa lënë gjurmë as edhe më të vogël në reagimet ndërkombëtare. Kjo për faktin se viktimë janë shqiptarët.

Nga ana tjetër një raport i rremë e tendencioz që nuk ofron as më të voglin argument trumbetohet me aq pompozitet sa kancelaritë perëndimore dërgojnë mesazhe serioze. Kjo për faktin se viktimë pretendohet të kenë qenë serbët.

Përse vallë kështu? Ku qëndron fajti, te ne apo te të tjerët?!!

Është folur aq shumë për raportin e Dik Martit saqë është shterur së diskutuari dhe nuk ia vlen të shtojmë asgjë. Mirëpo nëse e hedhim në krahasim atë raport me këtë të fundit, s'mund të kalohet pa u thënë disa fjalë.

Përse ngrihet aq pluhur kur ndonjë individ a grup shqiptar bën ndonjë problem nëpër botë, apo edhe më e keqja, pse shqiptarëve u ngjiten edhe të paqena vetëm e vetëm për t'i stigmatizuar si të egër e barbarë?!!

Dhe nga ana tjetër pse nuk thuhet asnjë fjalë kur shqiptarët janë viktimë, siç është ky rast, apo ai i të ndjerit Dedë Gecajt nga Janoshi i Gjakovës, i cili u soll nga autoritet zvicëranë nga burgu i St. Gallenit me arsyetimin se është vetëvararë përderisa autopsia tregon se nuk është ashtu?! Obduksioni tregoi se para vdekjes trupi i tij kishte pasur plagë nga goditjet në kokë dhe trup.

A është kjo më tepër pafuqi e zërit tonë në arenën ndërkombëtare, apo është aq e fuqishme urrejtja antishqiptare sa është vështirë për t'u luftuar?!

Për këtë mbetet të jepet përgjigje nga ndonjë studim i hollësishtëm. ■

VEPRA, E JO VETËM FJALË!

Astrit VELIÇI

Viti që lamë pas e la Kosovën me një nivel të lartë korrupsioni në shumë sfera publike e private. Sipas drejtorit të Agjencisë Anti-Korrupsion, Hasan Preteni, asnjë nga institucionet kosovare nuk i ka shpëtuar përfshirjes në vepra korruptive dhe, së këtejmi, ai nuk është i kënaqur me rezultatet e luftës kundër korrupsionit. “Korrupsioni në Kosovë është ende i pranishëm në masë shqetësuese.

Qytetari i Kosovës ka prituri më shumë punë në luftën kundër korrupsionit gjatë vitit 2010”. Ishin disa premtime e angazhime, por në fund doli se vërtet nuk mund të mburremi me rezultatet e arritura për vitin që lamë pas”, - është shprehur ai.

Kritikohet drejtësia

Raportohet se në 2010-ën, sektori më i korruptuar ka qenë ai i partive politike, për t’u pasuar nga sektori i gjyqësorisë. I pari i Agjencisë Anti-Korrupsion, kritikoi sistemin e drejtësisë për mosshqyrtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me korrupsionin. Edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile vazhdimisht kanë shprehur shqetësimet e tyre për nivelin e korrupsionit në vend.



Hasan Preteni – Agjencia Anti-Korrupsion

Ata u kanë bërë thirrje autoriteteve gjegjëse që në vitin 2011 të fillojnë një betejë më të madhe për luftimin e këtij fenomeni.

Drejtuasi i Organizatës për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet “Çohu”, Avni Zogiani, ka thënë se realiteti ka qenë i kundërt me premtimet, me gjithë retorikën me të cilën qeveria që e kishim në mandat, kishte ardhur në pushtet.

“Institucionet e Kosovës, për këtë periudhë kohore, në vend që të forcoheshin, janë dobësuar shumë. Të gjitha raportet kanë treguar se fusha anti-korrupsion është përkeqësuar në Kosovë”, - ka deklaruar ai.

Politika po ndërhyr në drejtësi



Avni Zogiani – ‘Çohu’

Ai fajësoi politikën se ka ndërhyrë në drejtësi, duke theksuar se ky problem rritet nga ndikimi i madh i politikës në institucionet e pavarura dhe në gjyqësor.

Edhe Lëvizja ‘FOL’, një organizatë joqeveritare në Kosovë, kërkon nga organet e rendit, vendore dhe ndërkombëtare, t’i bëjnë publike rezultatet e luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Ramadan Ilazi, nga kjo lëvizje, ka pohuar se autoritetet kompetente duhet t’u japin fund reagimeve retorike ndaj veprimeve kriminale dhe korrupsionit. Në situatën në të cilën gjendet Kosova nuk mund të ketë hapësirë edhe për korrupsion, edhe për përpjekje për sundim të ligjit. Lufta kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit në Republikën e Kosovës, me bindjen tonë të thellë, ka ardhur në një pikë kritike. Në situatën në të cilën jemi përsëri, lufta kundër krimin dhe korrupsionit është minimizuar vetëm në aspektin retorik, pra vetëm me fjalë”, - ka shtuar ai.



Ramadan Ilazi – ‘FOL’

Korrupsioni duhet dënuar

Ai vlerësoi se, duke qenë në këtë situatë, qytetarët e Republikës janë shikues të veprimeve që po rrënojnë vlerat demokratike të shoqërisë sonë dhe të ardhmen evropiane të vendit.

Mendim të njëjtë për korrupsionin kanë edhe qytetarët. Ata thonë se lufta më shumë po bëhet me retorikë, se sa me vepra konkrete. Liridon Gashi, qytetar,

thotë se korrupsioni po e shkatërron shoqërinë kosovare dhe lufta ndaj tij nuk ka dhënë rezultat deri më tani.

“Mendoj se korrupsioni duhet të luftohet me vepra e jo më fjalë, ashtu siç po ndodh te ne dhe ata që vërtetohen se janë të korruptuar duhet të dënohen medoemos”, - ka shtuar Gashi.

Po ashtu, një numër të konsiderueshëm lëndësh, që kanë të bëjnë me korrupsionin, kanë pasur edhe prokurorët e misionit evropian për sundimin e ligjit.

Zëdhënësi i EULEX-it, Blerim Krasniqi, ka thënë se sa i përket punës së gjykatësve, që nga fillimi i punës së EULEX-it në Kosovë, janë marrë rreth 160 vendime, nga të cilat 13 janë vendime për korrupsion dhe 4 për krim të organizuar.

“Kurse sa i përket numrit të lëndëve të krimin të organizuar dhe të korrupsionit, prokurorët e EULEX-it janë marrë me mbi 55 raste të krimin të organizuar dhe 91 raste të korrupsionit.”

EULEX-i ka ngritur 58 aktakuza

“Deri më tani prokurorët e EULEX-it kanë ngritur 58 aktakuza”, -ka thënë Krasniqi.

Kurse sa i përket arrestimeve të personave të dyshuar, Krasniqi e shpjegoi në këtë mënyrë:

“Një person mund të mbahet në paraburgim vetëm nëse vazhdon ta përsërisë kryerjen e krimin, nëse i pengon hetimet dhe në rast se mund të largohet nga vendi. Nëse prokurorët kanë dyshime për këto (vepra), këta persona mbahen në paraburgim.”

E siç dihet tashmë lufta kundër korrupsionit është vënë në krye të agjendës së institucioneve vendore, por deri më tash, rezultatet në këtë rrafsh nuk kanë qenë aq të shumta.

Sikurse dihet domosdoshmëria për këto rezultate është përmendur edhe në disa raporte të organizatave ndërkombëtare në fund të vitit të kaluar, ku nuk flitej në të mirë të luftës kundërkorrupsion.

Përndryshe, Qeveria e Kosovës vazhdimisht deklarohet për ‘zero tolerancë’ ndaj korrupsionit. Në shkurt të vitit të kaluar është marrë vendimi për krijimin e një departamenti të veçantë, që quhet ‘Task-forcë’, për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, e cila me përjashtim të disa rasteve nuk ka bërë më shumë, edhe pse funksionon në kuadër të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës. ■

FILLON ZBATIMI I LIGJIT PËR DUHANIN

Fatos RUSHITI

Edhe pse ligji për duhanin ka qenë i miratuar qysh më 2005, gjer më tani nuk është zbatuar dhe askush nuk është ndëshkuar për pirjen e duhanit në hapësirat publike. Më kot nëpër muret e lokaleve qëndrojnë të varura shenjat për ndalimin e pirjes së duhanit; ato nuk i respekton asnjëri, ashtu siç nuk i kanë respektuar edhe ata që e kanë sjellë këtë ligj – deputetët e Kuvendit të Kosovës. Më tepër për këtë ligj është përfolur sesa është ndërmarrë diçka konkrete. Nuk është sensibilizuar opinioni, nuk janë vënë në veprim mekanizmat ligjorë që do të sanksiononin përdorimin e tij në vendet publike, si dhe nuk është bërë pothuajse asgjë për ndërgjegjësimin e qytetarëve. Rrjedhimisht, sot po të pyesësh qytetarin e thjeshtë për këtë çështje, ai do t'i rruhdhte supet pa thënë gjë. Me fjalë të tjera, lihet përshtypja se s'ndodh gjë në këtë drejtim.

Megjithatë, prej këtij muaji është paralizuar se ky ligj izohet dhe do të gjejë



aplikueshmëri. Inspektorë të shumtë janë hedhur në terren për të kontrolluar lokalet ku vazhdon edhe më tej injorimi i këtij ligji. Për shkelësit e ligjit është paraparë gjoja në të holla. Për pronarët dhe përgjegjësit e institucioneve dënimi varion prej tre mijë deri në pesë mijë euro, ndërsa për prodhuesit dhe importuesit e duhanit dënimi sillet prej pesë deri në dhjetë mijë euro. Për qytetarët e thjeshtë ndëshkimi për mosrespektimin e ligjit arrin deri në 20 euro. Ligji parasheh ndalimin e pirjes së duhanit në hapësirat publike, përpos në ato të cilat janë të parapara për pirje të duhanit. Ndalimi përfshin edhe të gjitha hapësirat e institucioneve ku ofrohen shërbimet shëndetësore, qofshin ato publike ose private. Po ashtu, ndalimi përfshin edhe institucionet e edukimit. 70 % e lokalit do të jetë zonë ku ndalohet pirja, kurse pjesa tjetër do të jetë hapësirë që do të jetë e dedikuar për duhanpirësit. Gjithashtu, ndalohet shitja e cigareve të miturve nën 18 vjeç.

Masa e përcaktuar parasheh edhe vendosjen obligative të shenjave për ndalimin e pirjes së duhanit në vendet e përcaktuara me ligj.

Sipas të gjitha gjasave, vendi ynë është një ndër vendet evropiane ku duhani konsumohet më së shumti. Kosova ka 600 mijë duhanxhinj që, brenda ditës, shpenzojnë së bashku gjysmë milion euro për të blerë cigare. Kjo do të thotë se çdo i pesti person në Kosovë llogaritet të jetë duhanpirës. Prej dy mijë hospitalizimeve

që bëhen në Klinikën Pulmologjike në Prishtinë, 500 janë të lidhura drejtpërdrejt me pirjen e duhanit.

Janë disa faktorë të cilët e kush-tëzojnë konsumimin e duhanit, ndër të cilët vlen të veçohen: kriza ekonomiko-sociale dhe ato emocionale (në duhan shihet prehja dhe ngushëllimi), dëshira për t'u dukur (është një zhvillim psiko-emocional që duhanin e sheh si një simbol për të ekspozuar ngritjen e personalitetit para syve të të tjerëve) dhe varësia, e cila injoron faktet (ata që e përdorin janë të varur dhe shtiren se bukën mund ta lënë e duhanin jo dhe pikërisht këta çdo argument për dëmet e duhanit e injorojnë madje edhe duke u tallur me të dhënat mjekësore, e duke u bazuar në disa raste ekskluzive të ca pleqve që njohin e të cilët janë shëndosh e mirë, po që kanë konsumuar duhanin që nga fëmijëria). Pra, përdorimi i duhanit ka disa dimensione psikike, të cilat më pas kanë ndikim edhe në zhvillimet sociale, për faktin se nëse përdorimi është problem psikik (i vetë konsumuesit), ai pastaj zgjerohet, duke e tejkalluar individin dhe bëhet problem social.

Në sensibilizimin e zbatueshmërisë së ligjit një kontribut të veçantë mund të luajnë edhe mediat. Ato kanë rol edukativ dhe në vazhden e këtij roli, ato duhet të kenë funksion kundër të keqes. Me fjalë të tjera, mediat janë promotore dhe gjeneratore të vlerave në shoqëri. Ato duhet të thërrasin në debat të hapur ekspert të lëmenjve të ndryshëm: mjekë, psikologë, sociologë, pedagogë etj. të cilët do të flisnin me kompetencë për efektet negative të duhanit, si për individin, ashtu edhe për shoqërinë. ■

Shoqata Kulturore “Zëri Ynë” organizoi një tryezë me temën “Shqiptarët si faktor stabiliteti në

SHQIPTARËT S’PATËN FAT QË K



Muhamet JAHIRI

Shoqata Kulturore “Zëri Ynë” ka organizuar një tryezë me temën “Shqiptarët si faktor stabiliteti në rajon”, në të cilën është diskutuar kryesisht për fatin e shqiptarëve gjatë historisë, si dhe për ndikimin e tyre në stabilitetin e rajonit pas pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin përfaqësues nga të gjitha viset shqiptare.

Me këtë rast, nikoqiri i kësaj tryeze Muhamed Jusufi, ka thënë se Evropa, në të cilën tranzicioni kishte filluar para njëzet viteve, nuk arriti të kalonte pa luftë.

“Ishte fati i njerëzimit që shtetet e Evropës Lindore ta kalonin tranzicionin e tyre pa luftë, por këtë fat nuk e pati Federata Jugosllave, e cila u zhyt brenda nacionalizmit, gjë e cila i detyroi të gjitha shtetet përreth të qëndronin të mobilizuara”, - tha Jusufi, duke shtuar se tranzicioni në Ballkan ishte më i gjatë dhe më i vështirë sesa ishte imagjinuar.

“Ishte tranzicion shumë më i vështirë ngase shteti ynë, së pari duhej të përballlej me vetveten, sepse kishte kaluar njërin nga regjimet më të egra në botë dhe e dyta kishte të bënte me atë sesi t’u dilte në ndihmë të gjithë vëllezërve përreth, të cilët shtriheshin në një hapësirë

geografike”, - ka thënë ai.

Jusufi ka theksuar se lufta dhe tranzicioni i vështirë nuk i kishte përfshirë vetëm shqiptarët e Kosovës, por një fat të ngjashëm e kishin përjetuar edhe shqiptarët e Maqedonisë, të cilëve u ishte imponuar edhe lufta ndaj pushtetit sllavo-maqedonas.

“Jo vetëm Kosova ishte brengë e shtetit amë, por edhe Maqedonia, ku populli shqiptar atje u detyra të zhvillonte një luftë kundër regjimit sllavo-maqedonas dhe deri-diku i fitoi disa të drejta me firmosjen e Marrëveshjes së Ohrit, e cila ende nuk është duke u implementuar”, - ka theksuar Jusufi, duke



rajon”.

ISHIN FQINJ SLLAVËT E GREKËT



shtuar se shqiptarët ende nuk janë të stabilizuar në rajon.

Krasniqi: Kosova dhe Shqipëria duhet ta padisin shtetin serb për gjenocid

Lidhur me rolin e shqiptarëve në Ballkan foli edhe profesor Milazim Krasniqi, i cili deklaroi se pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë shqiptarët arritën me mund të madh që ta shpallin Kosovën shtet të pavarur.

“Në kuadër të shpërbërjes së dhunshme të ish-Jugosllavisë, edhe pavarësia e Kosovës ka ardhur si rezultat i kapaciteteve të shqiptarëve për të mbajtur një proces të destabilizimit në këtë pjesë të rajonit dhe për ta frikësuar Evropën nga vala e refugjatëve nga këto rajone dhe për ta sfiduar procesin e integritetit të rajonit në strukturat evropiane”, - ka thënë Krasniqi.

Sipas tij, shqiptarët gjatë gjithë historisë ishin të anashkaluar nga Evropa, gjë e cila ndikoi që shumë terriore shqiptare të binin nën pushtimin sllav dhe grek.

“Nga viti 1912, kur viset shqiptare ranë nën okupimin sllav dhe ato jugore nën atë grek, faktikisht Evropa ka qenë e pangjishme ndaj kërkesave të shqiptarëve, bile-bile edhe ndaj atyre minimale për mbrojtjen fizike të tyre”, - është shprehur profesor Krasniqi, duke shtuar se edhe Marrëveshja e Shën Zhermenit

e përjashtonte mbrojtjen e statusit të shqiptarëve si minoritet.

Ndër të tjera, Krasniqi ka theksuar se shqiptarët si pak popuj të tjerë kanë pasur një fat të keq, sepse kanë pasur fqinj të këqij pranë vetes, veçmas serbët në veri dhe grekët në jug, të cilët tradicionalisht dhe vazhdimisht kanë deklaruar aspirata gllabëruese dhe asimiluese.

“Kështu që edhe vullneti i mirë i shqiptarëve, i cili mund të shihet edhe në deklaratën për pavarësi në vitin 1912, nuk ka arritur të përmbushet si vullnet, ngase vullneti i shqiptarëve për paqe me popujt fqinjë gjithmonë është injoruar”, - është shprehur ai.

Profesor Krasniqi në tezën e tij ka deklaruar se politika sllave ndaj shqiptarëve të Kosovës nuk ka ndryshuar as në shekullin e njëzetën kur shumica e vendeve tashmë e kanë kaluar fazën e tranzicionit. Ai ka shprehur bindjen e tij se Kosova, në bashkëpunim me Shqipërinë, duhet të ngrënë vepër penale në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, ndaj shtetit serb për spastrimet etnike që ka bërë në Kosovë.

“Kjo politike ka vazhduar deri me sot dhe qasja e shqiptarëve në përgjithësi dhe e Kosovës në veçanti në raport me politikën destabilizuese dhe agresive të Serbisë do të duhej të hiqte dorë nga tonet skajshmërisht pajtuese. Kosova, në bashkëpunim me Shqipërinë, do të duhej të ngrinte vepër penale në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, për spastrimin etnik dhe gjenocidin që është shkaktuar në Kosovë, sepse ajo që ka ndodhur në vitet 1998 është e faktuar me një spastrim, i cili shkaktoi një

milion refugjatë dhe me shkatërrim të tërësishëm”, - është shprehur ai.

Ndër të tjera, profesor Krasniqi ka thënë se edhe shqiptarët e Maqedonisë u detyruan me forcë që t'i kërkojnë të drejtat e tyre. Sipas tij, edhe pse është nënshkruar marrëveshja paqësore e Ohrit, e cila i siguron të drejtat e shqiptarëve atje, një gjë e tillë nuk po zbatohet në terren.

“Marrëveshja e Ohrit e cila i dha fund konfliktit të armatosur në vitin 2001, ka ardhur si rezultat i proceseve destabilizuese të shqiptarëve dhe vetë fakti që kjo marrëveshje ende nuk po zbatohet, tregon se nuk ka pasur dhe nuk ka ende vullnet politik, për ta zbatuar këtë”, - ka deklaruar Krasniqi.

Maloku: Ballkani është ballafaquar me sfidën e identitetit

Ndërkaq, Fadil Maloku ka theksuar se shqiptarët gjatë gjithë historisë kanë treguar shembullin për stabilitet. Maloku ka deklaruar se me rënien e Murit të Berlinit edhe në Ballkan u krijuan kushtet për fillimin e ndërtimit të demokracisë.

“Ballkani është ballafaquar me sfidën e identitetit të vet dhe me tranzicion. Nëse i qasemi një historie të shkurtër mund të themi se në Evropë janë hartuar rregulla, të cilat e kanë futur Ballkanin përëndimor në një agjendë”, - është shprehur ai.

Sipas tij, gjatë gjithë shekujve XIX-XX-të janë provuar një seri konceptesh lidhur me ardhmërinë e pjesëve të ndryshme të Evropës, të cilat për shkak të proporcionit dhe ardhmërisë zhvillimore, janë shkatërruar përmes luftërave dhe spastrimeve. ■





Intervistë me dr. Milazim Krasniqi

ZBEHJA E IDE PRODHON PA (AUTO)DEST

- Mungesa e fuqisë i pengon shqiptarët të jenë faktorë
- Nëse shqiptarët do të ishin faktorë nuk do të ndodhte edhe raporti i Dick Marty-t
- Shqiptarët duhet të veprojnë në unison, duke përpiluar një strategji të përbashkët veprimi

Intervistoi: Osman D. GASHI

Shqiptarët gjatë historisë së tyre të zhvillimit si komb, në territorin e tyre, deri në fillim të shekullit të XXI-të, kanë kaluar nëpër peripeci, sfida e luftëra të shumta. Si pasojë e fatit të rëndë, e fqinjëve të egër me pretendime pushtuese, pastaj e pamundësisë për të qenë faktor, shqiptarët janë ndarë në shumë shtete, kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë probleme të natyrave të ndryshme ekonomike, sociale, janë më të pazhvilluarit të rajon, kanë probleme e sfida të brendshme e të jashtme, etj.

Pikërisht për temën e të qenit fak-

tor të shqiptarëve dhe për pozitën e tanishme të tyre në këtë fillimshkull, biseduam me profesorin dhe analistin Milazim Krasniqi. Në vijim shqyrtohen çështje të tilla si: dëshira e të qenit faktor, rrethanat, sfidat që shqiptarët vërtet të jenë të tillë, problemet e brendshme dhe të jashtme që kanë shqiptarët, qëndrimi i ndërkombëtarëve ndaj shqiptarëve, si duhet rregulluar ky raport i shqiptarëve me ndërkombëtarët dhe tema të tjera.

PAQJA: Në një tryezë të rrumbullakët që ka organizuar shoqata kulturore "Zëri Ynë" me titull "Shqiptarët si faktor stabiliteti në rajon", ju keni marrë pjesë me

një kumtesë. A është ky titull vetëm një dëshirë apo edhe realitet i mundshëm, duke pasur parasysh edhe rrethanat e shumta që e pengojnë këtë çështje?

Krasniqi: Vullneti i shqiptarëve për të qenë faktor stabiliteti në rajon është i njohur që nga ideja e formimit të kombit dhe shtetit shqiptar, pra, që nga rilindësit. Ata gjithmonë kanë manifestuar një dëshirë që të jetojnë në paqe me fqinjët. Edhe themeluesi i shtetit shqiptar, Ismail Qemali, në deklaratën e themelimit të shtetit përmend pikërisht këtë postulat të dëshirës së shqiptarëve që të jetojnë në paqe me fqinjët. Këtë postulat e ka pasur edhe lëvizja e shqiptarëve

ENTITETIT FUQI DHE TRUKSION

në Kosovë e shekullit të XX-të dhe në përgjithësi ky përcaktim dominon edhe sot. Por, fati i keq i yni ka qenë që fqinjët tanë nuk e kanë miratuar këtë orientim tonin. Përkundrazi, ata përmes destabilizimit të rajonit, përmes agresioneve, kanë qenë përfitues të mëdhenj në dëm të shqiptarëve, kështu që, në këtë aspekt, ne thjesht kemi pasur një situatë që është shprehje edhe e dobësisë së brendshme. Në fakt ne kemi qenë destabilizues nga brenda, në konflikte politike e sociale të ndryshme, ndërsa stabilizues në raport me të tjerët. Kështu i bie që kemi qenë të paaftë në periudha të caktuara historike për të mbrojtur interesat kombëtare edhe përmes destabilizimit të rajonit. Me një fjalë ky është një fat i keq që na karakterizon edhe sot, kur prapë kemi një vullnet për të qenë paqësorë, por ser-

ish kemi fqinj armiqësorë si serbët, që kanë përfituar dhe po përfitojnë përmes dhunës dhe destabilizimit.

Mungesa e fuqisë i pengon shqiptarët të jenë faktorë

PAQJA: *Çfarë i cenon konkretisht shqiptarët që të jenë faktorë: e kaluara, ndasitë ideologjike, mosharmonizimi i qëndrimeve në nivel kombëtar, feja apo moskoordinimi i duhur në rrafshin ekonomik e social?*

Krasniqi: Në të vërtetë, mungesa e fuqisë është problemi kryesor. Sepse, ne shqiptarët nuk kemi fuqinë e duhur adekuate ekonomike, politike e ushtarake, e cila do të bënte që ne t'i mbrojmë interesat kombëtare qoftë edhe duke e destabilizuar rajonin. Në këtë kontekst, mendoj që problemi më i madh i shqiptarëve janë elitat politike, fetare, ekonomike, sindikale, të cilat në të vërtetë janë me një prejardhje diku të korruptuar, diku komuniste, diku janë më shumë si dekor i pushtetit dhe si të tilla ato nuk e kryejnë punën e vet, nuk arrijnë që të shpërfaqin kapacitetet reale të kombit tonë, prandaj në sytë e të tjerëve ne dukemi shumë më të dobët nga sa jemi realisht në pikëpamje demografike ose gjeopolitike. Pra, kemi një krizë të përfaqësimit të kombit shqiptar, qoftë në politikë, qoftë në fushën intelektuale, fetare, sindikale, qoftë ekonomike. Prandaj, ky përfaqësim i gjymtë, jodinjitoz, na bën që të dukemi edhe më të dobët nga sa jemi realisht. Me një fjalë, dobësia më e madhe e kombit tonë është kriza e përfaqësimit.

PAQJA: *Në tërë këto probleme të brendshme që krijojnë këtë dobësi të të qenit faktor të shqiptarëve, a mund të interferohet edhe faktori ndërkombëtar për të jetësuar edhe moton e tryezës në të cilën ju keni marrë pjesë?*

Krasniqi: Faktori ndërkombëtar ka qenë mospërfillës dhe injorues ndaj interesave të shqiptarëve, së paku gjatë historisë së re të Evropës, që nga Kongresi i Berlinit e këndej, sepse ka plotësuar më shumë apetitet e orekset e fqinjëve ballkanikë në dëm tonin, edhe për faktin se ne nuk kemi pasur fuqi që ta destabilizojmë rajonin. P.sh. fqinjët tanë kanë pasur sponsorizimin e Rusisë në rend të parë, por edhe të disa fuqive tjera evropiane dhe kanë mundur që ta destabilizojnë rajonin dhe Evropën përmes luftërave ballkanike e botërore,

përmes të cilave kanë fituar territore nëpër periudha të ndryshme historike, ndërsa ne shqiptarët këtë fuqi nuk e kemi pasur, meqë nuk kemi pasur as sponsor të fortë. Fitimin e vetëm real e kemi pasur më 1912 me krijimin e shtetit shqiptar në vorbullën e shpërbërjes së Ballkanit, ndërsa fitoren e dytë e kemi pasur në fund të shekullit të XX-të, në fund të shpërbërjes së ish-federatës jugosllave. Pra, kemi përfituar nga disa kriza rajonale, por jo në përpjesëtim me atë që na takon dhe me atë që realisht ka qenë aspirata e shqiptarëve.

Nëse shqiptarët do të ishin faktorë nuk do të ndodhte edhe raporti i Dick Marty-t

PAQJA: *Duke u ndërlidhur me faktorin ndërkombëtar, kohëve të fundit kemi edhe një raport të eurodeputetit Dick Marty, përmes të cilit ai i paraqet shqiptarët me një imazh negativ. Po të ishin shqiptarët faktor i vërtetë, a do të kishte mundur ky raport të prezantohej apo të kishte këto pasoja që ka tani?*

Krasniqi: Unë besoj se absolutisht jo. Sepse po të shikojmë serbët fjala vjen, ata janë një komb që ka bërë gjenocid të paparë në Bosnje, duke përfshirë edhe Srebrenicën, për çka madje as Gjykata e Drejtësisë në Hagë nuk e ka dënuar këtë, e as nuk e ka gjykuar si gjenocid. Serbët, po ashtu, kanë bërë krime të papara edhe në Kosovë. Kemi shembull kur më shumë se një mijë të vrarë i kanë bartur më shumë se 400 kilometra larg dhe i kanë varrosur në Batajnicë me idenë që t'i fshijnë gjurmët. Kanë hedhur me qindra njerëz të tjerë nëpër liqene, si në Liqenin e Peruqacit, ku kufomat janë bartur me kamion frigorifer e janë hedhur në ujë, ndërsa as Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe as një institucion tjetër ndërkombëtar nuk i ka dënuar këto krime monstruoze. Nuk është miratuar ndonjë rezolutë në Asamblenë Parlamentare për to, ndërsa me një raport morbid, idiotik, kriminal e banditesk të antishqiptarit Dick Marty, një pjesë e madhe e Evropës dhe e medive janë ngritur në këmbë me një histeri patologjike antishqiptare. Në fakt, çdo lëvizje sado e vogël e shqiptarëve futet në llupë dyshimesh për një arsye dhe kjo thuhet haptas: një pjesë e Evropës ka paragjyqime raciste ndaj shqiptarëve. Na trajtojnë si popull primitiv, na trajtojnë si një popull që jemi ndërtuar mbi kodin patriarkal dhe kanë krijuar



stereotipin sipas të cilit madje edhe natyra e mafisë shqiptare ka prejardhje gjenetike. Me një fjalë, Evropa e ka me sherr në këtë aspekt, me paragjykimet e vjetra e të reja dhe po të ishte për hir të saj, jam shumë i bindur që as spastrimi etnik e as gjenocidi i serbëve nuk do të parandalohej. Ne kemi pasur një fat të madh mbi tërë këtë fatkeqësi, që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, brenda rolit të tyre si superfuqi botërore, kanë luajtur një rol në parandalimin e atij spastrimi etnik dhe atij gjenocidi dhe Evropën e ka mbajtur thjesht lidhur pas qerres. Tani që ndikimi amerikan po bie në Evropë dhe në Ballkan, në shumë qarqe evropiane po ngrihen përsëri lugatë me prirje antishqiptare. Dick Marty është vetëm një personazh episodik i këtij disponimi kronik dhe endemik antishqiptar në Evropë.

PAQJA: Në kuadër të këtij qëndrimi të Evropës ndaj Kosovës, duke e mbajtur të izoluar, duke mos i liberalizuar vizat dhe duke mos e integruar në Bashkimin Evropian, a po ndikojnë këto pasoja që shqiptarët të mos mund të bëhen faktor në rajon?

Krasniqi: Izolimi i Kosovës, në të vërtetë, është simptomë direkt i qëndrimit antishqiptar që ekziston në një

pjesë të madhe të Evropës, sepse nuk është normale që në tërë rajonin e Ballkanit vetëm Kosova ka mbetur e izoluar, faktikisht në karantinë. Kjo bëhet me qëllim që të shqiptarët të provokohen sa më shumë frustrime dhe përmes kësaj të prodhohen rebelime ose forma të tjera të dhunës, për të dhënë pastaj pretekstin që të bëhet me gisht nga shqiptarët: ja këta janë ata që ne kemi thënë, primitivët e mafiozët e lindur të tillë. Me një fjalë, në Evropë nuk ekziston disponimi për t'i integruar shqiptarët dhe për t'i parë si pjesë të familjes evropiane. Faktikisht, agjendën e sotme evropiane e bëjnë shtetet që kanë qëndrim armiqësor ndaj Kosovës. Në BE janë ende pesë shtete që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës: Spanja, Rumania, Sllovakia, Qiproja dhe Greqia, ndërsa në Këshillin e Evropës, siç ka thënë edhe Denis MacShane, ish-ministër i shtetit për Evropë i Britanisë së Madhe, në një tekst në Independent, se rregullat e lojës i përcakton Rusia dhe miqtë e saj, pra, edhe atje ka një disponim armiqësor që u pa me draft raportin e Dick Marty-t. Ne jemi në situatën e një presioni në rritje të institucioneve evropiane, në rend të parë ndaj Kosovës dhe kjo vjen për shkak se miqtë e Serbisë tashmë janë rehabili-

tuar dhe Serbia, gjithashtu dhe ata, po e kthejnë goditjen, pas turpërimit që i pati ndodhur Serbisë në vitin 1999.

Shqiptarët duhet të veprojnë në unison, duke përpiluar një strategji të përbashkët veprimi



PAQJA: Çfarë duhet të bëjë Kosova në këtë rast?

Krasniqi: Kosova dhe Shqipëria duhet të veprojnë në unison, duke hartuar një strategji të përbashkët të zhvillimit komplementar ekonomik, arsimor, kulturor e politik, kështu që si alternativë e këtyre presioneve, do të duhej të hapej ideja e integritimit ndoshta edhe e bashkimit kombëtar, për t'iu përgjigjur kështu presionit në rritje që vjen nga armiqët e Kosovës. Por kjo nuk mund të bëhet me aktivistët e "Vetëvendosjes", që në njërin anë kërkojnë konflikt civil në Kosovë, e në anën tjetër bashkim kombëtar. Këtë proces do të duhej ta udhëheqin elitat intelektuale dhe elitat politike të shqiptarëve të të dyja shteteve tona.

PAQJA: Faik Konica në një fjali të tij shprehet: Në qoftë se Shqipëria do të vdiste ndonjëherë, atëherë në epitafin e saj do të duhej të shkruhej: "Shqipëria lindi nga Zoti, shpëtoi nga rastësia, vdiq nga shqiptarët (politikanët)." Si e komentoni ju këtë?


Krasniqi: Unë mendoj që Shqipëria dhe kombi shqiptar vërtet ka lindur si vullnet i Zotit. Sepse Zoti është Krijues i fiseve, i popujve dhe i gjithçkaje, kështu që në këtë kontekst ne jemi në pajtim me vullnetin e Zotit, edhe kombi edhe gjuha jonë, pra identiteti ynë. Por, ne kemi një devijim nga ky vullnet, sepse jemi një nga popujt që në një pjesë të madhe të tij ka qenë dhe është i rrez-

atuar nga drita e besimit, nga drita e Islamit, por në një proces të tromaksur kulturor politik e të një devijimi tragjik moral, një pjesë e madhe kanë hequr dorë prej këtij rrezatimi kështu që edhe kjo që ndodh me ne është si pasojë e drejtpërdrejtë e këtij çmoralizimi që ka përjetuar shoqëria jonë dhe kombi ynë, veçmas në periudhën e okupimit sllav dhe gjatë periudhës së sundimit komunist mbi kombin shqiptar. Prandaj, ajo çfarë ne duhet të bëjmë është se ne duhet të bëjmë përpjekje serioze, të kthehemi në identitetin tonë të vërtetë moral, kombëtar e fetar e të jetojmë në harmoni me atë që është edhe kërkesa e Zotit të botëve, pra, që të jemi një popull shembull për të mirë, një komb shembull i vlerave. Zoti ka dashtë që ne, në të njëjtën kohë, të jemi shqiptarë dhe evropianë, e po ashtu në të njëjtën kohë të jemi me pjesëmarrje dominuese muslimanë, prandaj do të duhej që këto shtresa të identitetit t'i harmonizojmë në mënyrë që prej tyre ta nxjerrim edhe fuqinë tonë dhe të ndikojmë që edhe ata që

paragjykime ndaj nesh të na shohin në një dritë tjetër. Sepse, për shkak të një shkalle të lartë të çmoralizimit që kanë përjetuar shoqëritë shqiptare në Kosovë e Shqipëri, Evropa na sheh me dyshim për shkak se ka shumë trafikantë, kontrabandistë, kriminelë, që bëjnë krime të ndryshme, ndërsa përmes mediatizimit të atyre veprave të shëmtuara, te qytetarët e atyre vendeve krijohet një perceptim për tërë shqiptarët si njerëz me sjellje devijante. Por, ato grupe të trafikantëve dhe kriminelëve shqiptarë që veprojnë nëpër Evropë, janë nusprodukte të çmoralizimit që ka ndodhur, e jo për shkak të identitetit tonë kombëtar ose fetar. Pra, është pikërisht e kundërta, ata shprehin këtë zbehje të dhimbshme të identitetit tonë të vërtetë kombëtar e fetar, sepse zbehja e identitetit tonë të vërtetë ka prodhuar edhe pafuqinë, edhe (auto)destrukcionin.

PAQJA: Çfarë duhet të bëjmë ne për këtë?

Krasniqi: Ne duhet të krijojmë një imunitet dhe një mekanizëm mbrojtës prej të keqes brenda nesh, për t'u mbrojtur vetë po edhe për t'iu mbrojtur të tjerët prej të keqes sonë. Kjo është një rrugë e cila na pret dhe prej asaj se si do ta menaxhojmë këtë rivitalizim moral, fetar dhe kombëtar, do të varet fuqizimi ynë shtetëror e kombëtar, po dhe ajo se si do të na shohin edhe të tjerët. ■



Intervistë me ish-ambasadorin e Maqedonisë në NATO, Nazmi Maliqin

MALIQI: SHQIPTARËT PO LUAJNË ROLIN

“Mendoj se ky shekull që jemi është historik për mirëvajtjen dhe domethënien e tërësisë shqiptare në Ballkan. Pra, jemi drejt asaj që shqiptarët ta luajnë rolin e një kombi lider në Ballkan”, - ka thënë Maliqi.

Qëndresë MUSTAFA

Ish-ambasadori i Maqedonisë në NATO, Nazmi Maliqi ka thënë për revistën “Paqja” se shqiptarët janë çelësi i stabilitetit rajonal, të cilët po luajnë rolin e një kombi lider në Ballkan.

“Mendoj se ky shekull që jemi është historik për mirëvajtjen dhe domethënien e tërësisë shqiptare në Ballkan. Pra, jemi drejt asaj që shqiptarët ta luajnë rolin e një kombi lider në Ballkan”, - ka thënë Maliqi

Për stabilitetin rajonal, sipas Maliqit, ka pasur rëndësi edhe shpallja e Kosovës si shtet i pavarur e sovran.

Maliqi konsideron se ndarja e Kosovës është një kartë shumë e nxehtë diplomatike dhe politike, ndërsa, sipas tij, hapja e dialogut me Serbinë do të jetë në favor të Kosovës.

“Aty do të hapen kartat dhe do të çelen ato se kush është borxhli ndaj tjetrit”, - është shprehur Maliqi.

Edhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO-së, Maliqi e konsideron si një mrekulli diplomatike që, sipas tij, ka ndikuar në stabilitetin rajonal.

Brengën më të madhe Maliqi e ka shfaqur te përçarja e politikës shqiptare të Maqedonisë, ndërsa për shqiptarët e Çamërisë ka thënë se janë drejt kthimit në tokat e tyre.

“Qarqet akademike dhe shkencore duhet të krijojnë një kulturë shtetërore në vend dhe të mos mendojnë që shteti është i partive politike dhe i maqedonasve, por të mendojnë që ai shtet është edhe i shqiptarëve dhe në këtë mënyrë të fillojnë komunikimin në baza të barabarta”, - është shprehur ai.

Maliqi çështjen e bashkimit kombëtar e ka konsideruar si një projekt shumë serioz dhe domethënës për shqiptarët.

Në fund, Maliqi ka përçarur një mesazh të studentët dhe intelektualët shqiptarë, duke kërkuar nga ta që të jenë pjesë në ndërtimin e politikave kombëtare shqiptare. Në vazhdim mund ta lexoni intervistën e plotë me ish-ambasadorin e Maqedonisë në NATO, Nazmi Maliqin.

PAQJA: Z. Maliqi, si e vlerësoni çështjen e shqiptarëve në Ballkan?

Maliqi: Duke pasur parasysh që karta gjeopolitike e shqiptarëve dallon nga ajo që ka qenë më parë, them se jemi drejt asaj që shqiptarët ta luajnë rolin e një kombi lider në Ballkan. Mendoj se ky rast nuk do t’u shpëtojë nga dora edhe bartësve të politikës, por edhe atyre që janë në projektet akademike, shkencore dhe universitare, sepse këto projekte duhet të ndryshohen mes vete për të mira. Mendoj se ky shekull që jemi është historik për mirëvajtjen dhe domethënien e tërësisë shqiptare në Ballkan.

PAQJA: Z. Maliqi, sa ka arritur pavarësia e Kosovës të krijojë stabilitet në Ballkan?

Maliqi: Pavarësia e Kosovës është çelës për stabilitetin në Ballkan dhe kjo çdo ditë po dëshmohet, pa marrë parasysh që ka edhe shikime pesimiste nga kënde të ndryshme. Të gjithë ata hulumtues që e njohin kartën politike të Ballkanit e ndajnë të njëjtin mendim sikurse unë. Kosova, pa marrë parasysh mangësitë që ka në stabilitetin e vet institucional dhe në fushat e tjera, luan një rol të rëndësishëm në region. Dashtë Zoti që edhe politikanët kosovarë ta kuptojnë rëndësinë e tyre edhe më të madhe në proceset në vijim, sepse tashmë çështjet varen nga ne.

PAQJA: Z. Maliqi, sa paraqet rrezik në Ballkan mospranimi i Pavarësisë së Kosovës nga Serbia?

Maliqi: Kosova është shtet i njohur ndërkombëtarisht, pa marrë parasysh se ka edhe shumë shtete për ta njohur. Shtetet që luajnë rol në kartën botërore, në politikat globale dhe euroatlantike e kanë njohur Kosovën, andaj ky vend duhet të shkojë guximshëm në këtë drejtim. Hapja e dialogut me Serbinë mendoj se do të jetë favor për Kosovën, sepse tashmë duhet të hapen kartat dhe duhet të çelen ato se kush është borxhli ndaj tjetrit. Dialogu nënkupton edhe kompromisin për çështje teknike, ku mundet të merren vesh mes vete. Unë mendoj se Serbia nuk do të jetë shumë e interesuar

për dialog, sepse pak i konvenon që të hapë dialog me Kosovën.

PAQJA: Z. Maliqi, me pavarësinë e Kosovës nuk janë zgjidhur të gjitha problemet në vend. A mendoni se po rrezikohet ndarja e Kosovës?

Maliqi: Kjo është një kartë shumë e nxehtë diplomatike dhe politike dhe të gjithë kanë drojë nga hapja e lojës për ndryshimin e kufijve. Të njëjtin problem e ka edhe Serbia, sepse tashmë ka një ringjallje për autonomin dhe ndarjen e Vojvodinës ku mund të ndodhin edhe procese të tjera brenda Serbisë. Ndërimi i kufijve ose ndarja e Kosovës është projekt të cilin Serbia nuk guxon të luajë, sepse pastaj vijnë sfida të tjera të ballafaqimit diplomatik dhe këtu vjen në pyetje Presheva, Bujanovci, Medvegja. Serbia më tepër është e interesuar për projektin e fundit që të ketë një autonomi territoriale me më shumë kompetenca.

PAQJA: Z. Maliqi si e shihni Kosovën pas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit dhe mbështetjes nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë?



LIN E NJË KOMBI LIDER NË BALLKAN

Maliqi: Pas gjithë asaj përkrahje dhe atij procesi të shkëlqyer që doli nga GJND-ja dhe nga proceset e tjera që lidhen me kartën ndërkombëtare dhe Kosovën, është për t'u habitur pse nuk po i vazhdojnë njohjet. Problemin e ngecjes së këtij procesi e shoh te partitë politike shqiptare dhe qeveria e Kosovës, sepse ata nuk e kanë kuptuar seriozisht se çka do të thotë lobim frontal. Në marrëdhëniet ndërkombëtare mund të jenë edhe grupet, të cilët llojnë për Pavarësinë e Kosovës si për shembull studentët në vendet ku studiojnë në botë, por kjo nuk është bërë në Kosovë. Sikur u ngushtua rrethi dhe u partizua shumë ky proces. Kur e krahasoj çështjen e Kosovës në këtë aspekt me Maqedoninë, mendoj se ka munguar një projekt më serioz. Mirëpo kjo është mangësi që mund të korrigjohet në një të ardhme.

PAQJA: Z. Maliqi, sa ka ndikuar në stabilitetin e rajonit anëtarësimi i Shqipërisë në NATO?

Maliqi: Shqipëria ka bërë një mrekulli diplomatike me pranimin e saj në NATO. Shqipëria po afrohet çdo ditë e më guximshëm me politikën e NATO-s. Shqipëria ka zhvillim ekonomik, stabilitet të brendshëm institucional dhe

çka është më e rëndësishmja ka dhënë projekte paqësore për Ballkanin.

PAQJA: Z. Maliqi, a mendoni se moszbatimi i Marrëveshjes së Kornizës së Ohrit po krijon tensione mes shqiptarëve dhe maqedonasve?

Maliqi: Maqedonasit kanë mangësitë e veta për të krijuar një kulturë shtetërore për të pasur një komunikim më të mirëfillt politik. E njëjta gjë po ndodh edhe me subjektin politik shqiptar, të cilët kanë probleme mes vete dhe ato probleme të brendshme nganjëherë shkojnë në skajshmëri, që nuk ka kuptim të jetë ashtu, sepse Marrëveshja e Kornizës së Ohrit është një emërues i përbashkët, është një dokument i pranuar ndërkombëtarisht. Përveç rezolutës 1244, që ka qenë një dokument i favorshëm për shqiptarët jashtë Shqipërisë, Marrëveshja e Kornizës së Ohrit ka një peshë shumë të madhe. Mua më duket se njerëzit për përfitim politik ose partiak po harrojnë disa projekte më domethënëse që kanë të bëjnë me mirëqenien e shqiptarëve, por edhe me stabilitetin e shtetit të Maqedonisë, sepse shqiptarët që jetojnë aty janë domethënëse në këtë shtet. Qarqet akademike dhe shkencore duhet të krijojnë një kulturë shtetërore në vend

dhe të mos mendojnë që shteti është i partive politike dhe i maqedonasve, por ai shtet është edhe i shqiptarëve dhe në këtë mënyrë të fillojnë komunikimin në baza të barabarta.

PAQJA: Z. Maliqi, sa mund të sjellë destabilizim rajonal çështja e shqiptarëve në Çamëri?

Maliqi: Politika e Kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berishës, kishte një strategji domethënëse që nuk u ngatërrua me politikën e Greqisë për çështjen e Çamërisë para pranimit në NATO. Ajo ishte një mrekulli diplomatike e kryeministrit Berisha dhe si duket qeveria greke nuk pati se si t'i vihet në kundërshtim diplomatik Shqipërisë. Tash vetëm ka filluar të bisedohet për pronat e çamëve dhe për legalizimin e pronave të tyre dhe mund të ndodhë shumë shpejt edhe rikthimi i pronave të atyre njerëzve që janë dëbuar me dhunë. Ndoshta, shumë shpejt, kjo agjendë për shqiptarët e Çamërisë, që ka hyrë në Këshillin e Evropës, Unionin Evropian, do të jetë përmbajtësore dhe të njëjtëve do t'u kthehen tokat e tyre.

PAQJA: Z. Maliqi, kohëve të fundit po përflitet shumë edhe çështja e bashkimit kombëtar. Çka mund të na thonë?

Maliqi: Çështja e Bashkimit Kombëtar nuk është më një tabu temë dhe nuk është jashtë kornizave të projekteve shqiptare, por është një nga projektet shumë domethënëse shqiptare që diskutohet në qarqe shumë serioze. Ai projekt, nëse favorizohet, do të varet nga roli që do të marrin shqiptarët në Unionin Evropian dhe NATO dhe krahas këtyre integritimeve mendoj se forma do të jetë më e ndryshme për ndryshimin e kufijve.

PAQJA: Z. Maliqi, një mesazh për fund për të gjithë shqiptarët ngado që janë.

Maliqi: Mesazhi im është që studentët tanë dhe qarqet tona intelektuale të përfshihen në proceset politike dhe të jenë pjesë e proceseve të tyre, e jo të partizohen skajshëm dhe të kalojnë në politika servile partiake, por të jenë shumë domethënëse dhe lojalë në ndërtimin e politikave kombëtare shqiptare në çështjet sociale, ekonomike, kulturore. Pra, zëri i studentëve duhet të fillojë të ringjallet sepse këtë domethënie e kanë pasur studentët shqiptarë. ■



KOSOVA DHE SHQIPËRIA MUND TË BASHKOHEN

Muhamet JAHIRI

Eshtë drejtor i Qendrës Shqiptare për Studime të Sigurisë Kombëtare në Republikën e Shqipërisë, i cili flet për gjendjen e shqiptarëve në përgjithësi. Sipas tij, shekulli në të cilin po jetojmë është i shqiptarëve. Ky shekull solli ngjarjet më madhore: shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe hyrjen e Shqipërisë në NATO. Ai tregon se si gjatë gjithë historisë shqiptarët nuk kishin arritur t'i gëzonin të drejtat e tyre. Ndër të tjera ai konsideron se me kalimin e kohës do të zgjidhen problemet e shqiptarëve në gjithë Ballkanin, ndërsa e ardhmja e tyre do të jetë evropiane. Po ashtu, ai ka deklaruar se Kosova dhe Shqipëria mund të bashkohen në të ardhmen, sepse një gjë të tillë e lejon sipas tij edhe Kushtetuta e shtetit shqiptar.

Për më shumë flet për revistën "Paqja" drejtori i Qendrës Shqiptare për Studime për Sigurime Kombëtare në Republikën e Shqipërisë, Xhavit Shala.

PAQJA: Z. Shala si e vlerësoni rolin e shqiptarëve në Ballkan?

Shala: Roli ose pesha e shqiptarëve në Ballkan ka ardhur duke u ngritur në mënyrë progresive me zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare. Pra, ka avancuar edhe pesha e shqiptarëve si faktor stabiliteti dhe në një mënyrë, këta faktorë janë të ndërlidhur njëri me tjetrin; sepse nuk mund të ketë zgjidhje përfundimtare në Ballkan përderisa stabiliteti i shqiptarëve të jetë i rrezikuar. Shqipëria sot është anëtare e plotë e NATO-s dhe është duke u përpjekur që ta fitojë statusin për të qenë kandidat për integrim në Bashkimin Evropian, është një vend që po konsiderohet si statujë sigurie dhe në kuadër të saj kemi edhe misionet paqeruajtëse në kuadër të NATO-s. Në një mënyrë, Shqipëria ka ndikuar në paqen dhe stabilitetin në rajon, sidomos po të shikohet në hartën gjeopolitike shqiptare në Ballkan. Edhe në rastin e konfliktit në Kosovë, por edhe në rastin e konfliktit në Maqedoni, përsëri Shqipëria i ka mbështetur shqiptarët atje, por ka mbajtur një pozicion i cili nga vendet demokratike ndërkombëtare është konsideruar si faktor stabiliteti.

Pa zgjidhur çështjen përfundimtare të shqiptarëve në Ballkan nuk mund të

ketë paqe dhe stabilitet dhe kjo është një arritje shumë e madhe për ne shqiptarët, që kemi evoluar në një mbështetje të fuqishme ndërkombëtare, e cila ka ndikuar që hap pas hapi të korrigjohen edhe padrejtësitë që janë bërë ndaj shqiptarëve.

PAQJA: Z. Shala, si e vlerësoni shpalljen e pavarësisë së Kosovës?

Shala: Shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë një fitore e madhe dhe e paimaginueshme në këmbënguljen dhe në shpresën që bënë gjithë shqiptarët. Ne shqiptarët duhet të punojmë shumë që të mos ia harrojmë asnjëherë perëndimit këtë mbështetje që na ka dhënë dhe asnjëherë duhet të mos e humbasim këtë mbështetje nga perëndimi deri në zgjidhjen përfundimtare hap pas hapi të çështjes shqiptare në përgjithësi, e cila besoj se nuk është zgjidhur ende përfundimisht. Ne nuk mund të kërkojmë që e gjithë hapësira gjeopolitike shqiptare të bashkohet, nuk mund ta pretendojmë këtë për shkak të problemeve që ekzistojnë edhe në disa shtetet të tjera, por është mundësia që ta bëjmë edhe këtu zgjedhjen më të mirë të mundshme, sepse Kosova dhe Shqipëria si dy vende të pavarura kanë një të ardhme dhe nuk duhet të tolerojnë më tensione për shqiptarët në Ballkan.

PAQJA: Pavarësia e Kosovës ka krijuar një stabilitet. Por sa krijon destabilitet qëndrimi i shtetit serb karshi Republikës së Kosovës?

Shala: Këtu e ka fajin politika serbe dhe këtë faturë do ta paguajnë vetë ata, të cilët asnjëherë nuk i paraprijnë

opinionit serb për t'i thënë se Kosovën mund ta humbasim. Çështja e Kosovës më shumë është bërë çështje marketingu politik në Serbi, d.m.th. është çështje e cila përdoret për t'i fituar zgjedhjet dhe nuk mund të presim që sot Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe një gjë të tillë nuk e kërkojnë as ndërkombëtarët, sepse e dinë se çfarë peshe ka kjo. Por, ata do të jenë të detyruar që me Kosovën të bëjnë zgjidhjen e problemeve në nivele teknike, të cilat i lidhin këta dy popuj, të cilët janë në kontest me njëri-tjetrin, si për çështjen e të pagjeturve, çështjet ekonomike etj. Po ashtu do të ketë edhe mekanizma të tjerë, të cilët do ta detyrojnë Serbinë, sepse nëse Serbia dëshiron të hyjë në Bashkimin Evropian, atje ka ca kritere, por edhe nëse Serbia ka ambicie për të hyrë në NATO, ka ca kërkesa, dhe këtu do të kemi edhe ne shqiptarët ca kërkesa, sepse ne kemi të drejtën e vetos si Shqipëri. Por gjërat do të lëvizin hap pas hapi. E rëndësishme është që të fillojnë bisedimet Kosovë-Serbi dhe të zgjid-



EN. KËTË UA LEJON KUSHTETUTA SHQIPTARE.

hen ato probleme teknike që ekzistojnë dhe të sqarohet gjithçka. Serbia do të jetë e detyruar që të përballet me një presion ndërkombëtar, por sekuenca do të përdorë rregullisht për të rregulluar ose fituar zgjedhje në Serbi.

PAQJA: Z. Shala, është komentuar e analizuar shumë edhe për mundësinë e ndarjes së Kosovës. Cili është opinioni juaj për këtë. A mendoni se mund të tolerohet apo të paktën të diskutohet një gjë e tillë?

Shala: Këto janë probleme të cilat kanë të bëjnë me një proces. Ballkani akoma është në një proces në të cilin nuk kanë marrë zgjedhje shumë probleme. Nëse do të krijohet ose do të vijë deri te ndarja, atëherë do ta kishim të hapur "Kutinë e Pandorës" dhe do të bëheshin analiza dhe bashkë me të do të kishim edhe hapje të shumë problemeve të tjera në Ballkan, si në Maqedoni, Bosnjë, Serbi etj. Pra, askush nuk do që kësaj pune dhe këtij investimi që është bërë për dhjetë vite t'i vihet fundi për një ditë. Këtu kemi problemin me pjesën veriore të Kosovës, por problemi nuk është te shqiptarët, por problemin dhe përgjegjësinë kryesore e kanë forcat e para të cilët u futën në Kosovë dhe lejuan ndarjen e Mitrovicës, sepse po të kishte reagime të atëhershme nuk do të kishim ndarje të Mitrovicës. Por ky problem nuk mund

të zgjidhet vetëm nga shqiptarët, por do një zgjedhje ndërkombëtare. Nuk duhet të harrojmë se nëse do të diskutohet për ndarje, atëherë do të diskutohet edhe për ndarjet brenda shtetit serb. Maqedonia do të ketë probleme të tjera dhe nuk mendoj se ndokush në Ballkan është i interesuar për një gjë të tillë.

PAQJA: Po ndërhyrjet e Serbisë në punët e brendshme të Kosovës?

Shala: Ata kanë ndërhyrë dhe po përpiqen vazhdimisht të ndërhyjnë, por sa më shumë që të forcohen institucionet e Kosovës dhe sa më shumë që të rritet pesha e Kosovës aq më pak ndërhyrje do të ketë. Ky është një problem i cili është në dorën e vetë shqiptarëve. Për të kaluar kjo nevojitet edhe pak kohë, në mënyrë që edhe serbët të mësohen më këtë realitet, por nëse vazhdohet të ndërhyjë një shtet ndaj një shteti tjetër, atëherë ka sanksione ndërkombëtare dhe institucione ku mund të shqyrtohen këto probleme.

PAQJA: Z. Shala, si e konsideroni vlerësimin e shqiptarëve të Maqedonisë?

Shala: Problemet kryesore të shqiptarëve janë në shtetin e Maqedonisë. Shqiptarët atje sakrifkuan mjaft me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit, por fakti po tregon se shqiptarët po ndihen të provokuar, sepse ajo marrëveshje që në fillim u paragjykua. Edhe atje shqiptarët kanë pasur një komunikim të mirë me ndërkombëtarët dhe nuk kanë dashur që të krijojnë probleme dhe të kenë pretendime për ndarjen e Maqedonisë. Ata pranuan në një mënyrë që të jenë nën mëshirën e shtetit maqedonas, në kuptimin që të jenë bashkëpronarë të atij shteti. Maqedonasit po pretendojnë të jenë vetëm ata pronarë të atij shteti, por shqiptarët një gjë të tillë nuk do ta pranojnë asnjëherë dhe për këtë janë të bindur edhe vetë maqedonasit. Përveç kësaj, kam bindjen se maqedonasit akoma janë të interesuar dhe po këmbëngulin për ndarjen e Maqedonisë dhe për këtë ndarje duan t'i bëjnë fajtorë shqiptarët. Mirëpo, ne nuk duhet të biem në këtë grackë. Ne do të kërkojmë zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit në maksimum, sepse kjo marrëveshje ka një garanci ndërkombëtare dhe nënshkruese të kësaj marrëveshje kanë qenë përfaqësuesit më të lartë të

Bashkimit Evropian, të NATO-s dhe ata janë garantues të kësaj marrëveshje, prandaj ne do të kërkojmë nga ta që të ndikojnë në zbatimin e saj. Por, si pikë fillestare, Maqedonia duhet ta zgjidhë problemin e çështjes së emrit, sepse është problem shumë i madh dhe më pas duhet ta zgjidhë problemin me shqiptarët, sepse nëse nuk zgjidhet problemi me shqiptarët nuk ka paqe dhe stabilitet në Maqedoni.

PAQJA: Z. Shala, cili është roli i shtetit shqiptar në rajon?

Shala: Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO është fitorja më e madhe e popullit shqiptar, pas pavarësisë së Kosovës. Kjo fitore është e rëndësishme sepse po të studiohet edhe historia nga Kongresi i Berlinit e këndej mund të shohim se hapësira gjeopolitike e shqiptarëve është përdorur si copë për t'i kënaqur të tjerët. Mendoni Shqipërinë e 1912-s, e cila ishte e pushtuar nga të gjitha anët; mendoni Shqipërinë e pas krijimit të traktatit të Varshavës dhe mendojeni Shqipërinë anëtare të NATO-s. Është një fitore e madhe e cila ka të mira edhe për Kosovën dhe shton fuqinë edhe të vetë Kosovës. Kjo ka dhënë edhe një forcim të sigurisë dhe demokracisë, sepse po ta shihni kemi një rrethim të shtetit serb me shtete demokratike dhe anëtare të NATO-s. Por shpresoj se s'do të kalojë shumë kohë dhe Serbia do të jetë e orientuar drejt NATO-s, në mënyrë që Ballkani t'i zgjidhë përfundimisht problemet e sigurisë.

PAQJA: Folëm për problemet e shqiptarëve me të cilët në një mënyrë kufizohet Kosova direkt, po problemet e shqiptarëve në Çamëri?

Shala: Problemi i Çamërisë është i ndryshëm, sepse grekët atje bënë një spastrim të pastër etnik dhe po ta krahasojmë atë që bëri Millosheviçi në Kosovë, atë grekët e bënë në vitin 1944-'45. Atje shqiptarët kanë frikë të identifikohen si shqiptarë. Por të paktën deri vonë atje pronësia nuk është cenuar. Në fakt ka edhe një marrëveshje mes Shqipërisë dhe Greqisë, në vitin 1994, e cila nuk është zbatuar asnjëherë. Kjo është një çështje që koha do ta zbërthejë, por tashmë ka një vullnet të çamëve atje për t'i kërkuar të drejtat e tyre. ■

Pyetje

PAQJA: Z. Shala, Kushtetuta e shtetit shqiptar ka një preambulë në të cilën nuk përfshihet asnjë mundësi të bashkimit kombëtar.

Shala: Ka gjasa më tepër se do të na detyrojnë të tjerët për ta bërë bashkimin kombëtar, sepse nëse kemi dy shtete sovranë është e drejtë e tyre që të vendosin qytetarët e njërit dhe të tjetrit. Por sot ne nuk mund të pretendojmë një gjë të tillë, sepse krijimi i një konfederate shqiptare, do të jepte garanci të plota për minoritetet. Besoj se ky ka qenë shekulli i shqiptarëve, por ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm, që t'i kërkojmë vazhdimisht të drejtat tona dhe të kërkojmë vazhdimisht mbështetjen ndërkombëtare.

SHQIPTARËT - STABILIZUES AF

Nëse historikisht të krishterët kanë qenë në kundërshtim me muslimanët dhe anasjelltas, sot, midis tyre nuk ka armiqësi. Vizita e xhamive në Stamboll, Jerusalem dhe Kajro i dy papëve të fundit, duhet të jetë mesazh për të gjithë politikanët tanë.

Muhamed J. KAJOLLI

Politika globale e perëndimorëve në meshekullin e kaluar parashikonte një konflikt të gjerë me Islamin, por fillimisht do të duhej të mbaronte Lufta e Ftohtë. Ndërsa siç po shihet, çdo ditë e më shumë po vërtetohet teoria e analistëve pacifistë se Perëndimi dhe Islami mund të merren vesh për një bashkëjetesë midis tyre, edhe pse kanë divergjencë të herëpashershme. Pengues, hëpërhë, i këtij bashkimi fillestar në Ballkan janë intrigat e politikanëve serbë dhe grekë. Këto dy shtete ende shpresojnë se mund ta bindin ndonjë ditë Perëndimin se shqiptarët janë mbeturinë e Anadollit, ndryshe me gjuhën e sotme, se këta janë muslimanë ekstremistë, terroristë etj. Mirëpo sot çdo gjë është e qartë. Këta njihen si demagogë të llojit të tyre, sepse mundohen t'i justifikojnë me çdo kusht pushtimet e tyre të shekullit të kaluar.

Vërtet, ai i cili i studion shqiptarët do të shohë ngjyra të ndryshme, në të cilën predominon ngjyra islame. Mirëpo sistemi organizativ i tyre është ai perëndimor, ose thënë ndryshe laik. Duke qenë se shqiptarët ishin të gatuar me brumin islam dhe në esencë e kanë paqen dhe harmoninë ndërnjerezore, atyre nuk ju bëri përshtypje eksterritorialiteti serb i 39-të objekteve të dhuruar nga presidenti Ahtisari në pakon e tij për Kosovën.

Askush prej shqiptarëve nuk mund të thotë se kjo nuk ishte një padrejtësi shikuar me ligjet njerëzore, por kur është në pyetje frika e minoritetit serb në njërën anë dhe stabiliteti rajonal në anën tjetër, shqiptarët pa hezitim e pranuan këtë pako. Shumë kohë më parë, kështu kishin vepruar në emër të së drejtës dhe lirisë së shprehjes muslimanët e shek. XV-të, edhe pse në atë kohë ishin superfuqi botërore. Në atë kohë ata iu kishin lejuar ortodoksëve të kenë eksterritorialitet në Islamopolis (Stambollin e sotëm).

Edhe sot, muslimanëve në përgjithësi dhe shqiptarëve në veçanti nuk ju

bën përshtypje ndërtimi i kishave ose objekteve të tjera të kultit, për shkak të natyrshmërinë së tyre njerëzore. Shqiptarëve të besimit islam gjithashtu nuk ju bën përshtypje ose nuk u pengon fare prezenca e grekut Anastas Janullatos si kryesues i kishës ortodokse autoqefale shqiptare, ashtu sikurse që nuk u pengon prezenca e stërmadhe e priftërinjve katolikë italianë në Shqipëri.

Nëse shumica e shqiptarëve janë të indinjuar me dikë në rajon, ata janë push-tetarët tanë, të cilët pa ndonjë arsye pengojnë ngritjen e qendrave islame nëpër qytetet e mëdha, si në Shkup, Prishtinë e Tiranë. Tanimë secili e ka të qartë se besimtarët që frekuentojnë xhamitë po detyrohen të falen nëpër oborret e xhamive, ose shpeshherë i mbushin trotuarët dhe rrugët automobilistike.

Është e turpshme që shoqëria jonë, e cila mëton standardet evropiane, t'i lejojë besimtarët të falen në borë e në

shi. Të privohen nga kjo e drejtë e tyre elementare është diskriminim, sepse edhe këta si gjithë të tjerët paguajnë taksat e kërkuara nga shteti. Mirëpo ajo që është akoma më shqetësuese për besimtarët janë komentet e analistëve nëpër masmedia. Këta nuk merren me pakujdesinë, neglizhencën ose arsyet e pengesës qeveritare për mirëqenien e besimtarëve, por, sipas tyre, besimtarët dalin si elementet destabilizues dhe përçarës për vendin dhe rajonin.

T'u lejohej katolikëve të prishin shkollën për të ndërtuar katedralen në qendër të Prishtinës, ndonëse numri tyre është shumë i vogël, t'u lejohej ortodoksëve të ndërtojnë kishën e tyre të stërmadhe përballë Ministrisë së Mbrojtjes në Tiranë, t'u lejohej ortodoksëve maqedonas të ndërtojnë kishën e tyre në sheshin e Shkupit, (bile, në pronën e xhamisë Burmalit), e të privohen muslimanët që të ringrenë xhamitë e tyre që



PO DESTABILIZUES NË RAJON?

u ishin rrënuar nga regjimi komunist, ndonëse trualli i tyre ishte dhe është pronë e vakëfit, është për t'u habitur. Ajo që të habit edhe më shumë është se çdo hap që marrin muslimanët për t'i plotësuar nevojat imediate të tyre, i emërtojnë me emra që nuk i ka hije asnjë politikan, gazetari e pushtetari.

Është e natyrshme që politikanët përqipen që të mbajnë baraspeshën dhe të harmonizojnë politikën e tyre rajonale me ato globale, por, duke privuar vëllezërit e tyre nga e drejta e tyre elementare, politikanët tanë më shumë po ndihmojnë politikën serbe e greke, të cilët në arenën botërore njihen si destabilizues të rajonit. Nëse politika e brendshme shqiptare i privon muslimanët për t'i bërë të heshtur serbët dhe grekët e kanë gabim, sepse kështu po prodhojnë pakënaqësi brenda komunitetit më të madh fetar shqiptar.

Politikën shqiptare duhet të janë në harmoni me ato shtete që ndihmuan Kosovën për t'u çliruar nga pushtuesi serb, sepse të gjitha këto shtete nuk janë kundër ndërtimit të objekteve fetare islame në rajon. Sikur të ndahej një

vend më i madh për ndërtimin e një *namazxha-je* ose Qendre Islame nëpër kryeqytetet e sipërpërmendura, atëherë muslimanët nuk do të dukeshin se po përcjellin imazh negativ gjatë kryerjes së faljes së namazit të Bajrameve.

Evropianët dhe SH.B.A.-të këtë nevojë të muslimanëve e kishin kuptuar herët dhe u kishin lejuan atyre të ndërtonin qendra të tilla nëpër qytetet kryesore të vendeve të tyre, ndërsa këtu, fatkeqësisht, besimtarët privohen. Këtu mund të shtrohet pyetja, kujt i pengon ndërtimi i këtyre qendrave, amerikaneve, evropianëve apo politikanëve tanë që u ushqyen në shkollat komuniste?

Nuk ka dyshim se politikanët tanë akoma nuk janë zhveshur nga petku komunist dhe për këtë arsye e kemi këtë anarki në gjithë sistemin tonë qeverisës. Shikuar nga ky këndvështrim, nuk shihet asnjë dallim midis politikanëve shqiptarë të Shqipërisë, të Kosovës dhe atyre të Serbisë. Të ndodhur përpara sistemit shumë të sofistikuar të perëndimorëve, krahasuar me ne dhe brumit komunist të ngulitur prej kohësh në kokat e politikanëve tanë, këta të fundit mundohen t'i justifikojnë gabimet e tyre me lejin e ndërtimit të kishave katolike dhe ortodokse, në njërin anë dhe privimin e xhamive, në anën tjetër.

Përpara tyre paraqiten se janë mbrojtësit e kulturës perëndimore dhe parandaluesit e përhapjes së Islamit në perëndim, mu sikur serbët e maqedonasit që mundohen të mbrohen përpara tyre. Nuk është aspak për t'u habitur, sikur një privim i tillë të vinte nga serbët ose maqedonasit, mirëpo, kur këto sjellje ose politika vijnë nga vëllezërit tanë, prej atyre që në çdo cep të shtëpive të tyre del aromë e Islamit, është për t'u habitur. Me këso veprimesh politikanët tanë të mjerë mendojnë se po u hedhin hi syve të shëndoshë të amerikanëve dhe evropianëve!

Nuk dyshohet se në mendësinë e politikanëve tanë është ruajtja e sigurisë dhe stabilitetit në rajon, por, shikuar nga këndvështrimi i paraqitur në këtë temë, del se shqiptarët më shumë po i ndihmojnë politikës së përgjithshme destabilizuese, së bashku me serbët dhe maqedonasit. Duke qenë se shqiptarët nuk kanë politikanë të klasave të larta, atëherë qytetarët e tyre i sugjerojnë ata

që gjatë vizitave të tyre jashtë shtetit, në vend të kazinove t'i vizitojnë qendrat islamike nëpër të gjitha qytetet e mëdha të Amerikës dhe të Evropës.

Duke i bërë këto vizita, ata do të mrekullohen dhe njëkohësisht do të çlirohen nga parafytyrimet e pamjeve të xhamive të rrënuara ose të djegura në Beograd, Nish, Prilep e Manastir. Si serbët, ashtu edhe maqedonasit, po shfrytëzojnë nga rasti i mangësive të njohurive të përgjithshme të politikanëve tanë dhe po ju ofrojnë perëndimorëve mundësinë e pajtimit të mundshëm me ne. Mbase me arsye dhe me argumente!?

Nëse asgjë nuk ju thotë politikanëve tanë se tregtarët, të cilët iu japin donacione partive të tyre politike, janë të lidhur ngushtë me tregtarët dhe me fabrikantët serbë dhe nëse politikanëve tanë nuk ju thotë asgjë që qytetarët e tyre po shkojnë në Serbi për të marrë pasaportat, duke e ditur se atje duhet të deklarohen se janë shtetas të Serbisë, atëherë le të mos habiten se nga po ju vjen e gjithë kjo e keqe e mosnjohjeve të shtetit, ose le të mos habiten se nga po u buron serbëve i gjithë ky motiv për të gjetur një gjuhë bashkëpunimi me perëndimorët, kundër nesh.

Nëse tregu serb ka shtrirje në mbarë trojet shqiptare dhe nëse shumica e këtyre tregtarëve shqiptarë kanë lidhje të ngushta me politikanët tanë, atëherë gjithashtu le të mos i habitë fakti i vizitave të politikanëve tanë që ia bëjnë herë pas herë Beogradit. Nuk besoj se politikanët tanë shkojnë atje si triumfues, që t'iu bëjnë me dije serbëve se e drejta qëndron me shqiptarët dhe ata duhet të heqin dorë një herë e mirë.

Krejt në fund, paraqitja sa më e natyrshme e politikanëve tanë, do t'i bëjë ata më të preferuar te perëndimorët. Nëse historikisht të krishterët ishin në kundërshtim me muslimanët dhe anasjelltas, sot, midis tyre nuk ka armiqësi. Vizita e xhamive në Stamboll, Jerusalem dhe Kajro i dy papëve të fundit, duhet të jetë mesazh për të gjithë politikanët tanë. Këta reflektojnë një përmirësim të marrëdhënieve ndërkombëtare midis dy komuniteteve të mëdha në botë, përkundër atyre që mendojnë se luftërat që po zhvillohen tani në Lindjen e Mesme janë të karakterit fetar. ■



PËR ÇFARË POLITIKANË KA NEVOJË KOSOVA?

Tashmë nevoja për reformim në çdo segment shoqëror në demokracinë kosovare është më se e domosdoshme, por reformimi i partive politike është edhe më i domosdoshëm, sidomos në strukturën organizative edhe në politikën e mbajtjes së kuadrove politike e profesionalë në strukturat e tyre.

Ma. sc. Flamur HYSENI

Partitë politike në demokracinë kosovare thuhet janë në fund të shterjes së resurseve të tyre humane. Tani është koha që këto parti, së paku këto pesë që janë bërë pjesë e strukturës së Kuvendit të Republikës së Kosovës të fillojnë rikonsolidimin e tyre si në pikëpamje organizative, po ashtu edhe në mënyrën e tyre të orientimit të politikave të brendshme sa i përket plotësimit të tyre me kuadro profesionale, sepse nuk është e mjaftueshme që partia vetëm të mbushet me persona, por se çfarë ofrojnë ata për trendet aktuale të politikës bashkëkohore, kjo është një pikëpyetje e madhe.

Demokracia kosovare, aktualisht, është në filllet e para të konsolidimit dhe forcimit të bazës së saj të funksionimit të mirëfilltë. Ajo nuk ka nevojë në asnjë mënyrë të ngulfatet me politikanë të shpenzuar, të cilët nuk janë në formë të mirë, të paktën as në paraqitjet e tyre publike, qofshin ato edhe tre minuta (analizo paraqitjet e gjashtë muajve të fundit në mediet elektronike të vendit, përfaqësuesit e partive politike, sidomos atyre të opozitës, të cilët u paraqitën në debatet e organizuara në emisionet Rubikon, Jeta në Kosovë, Debat, Zoom, etj.).

Kosova tanimë është shpallur shtet i pavarur dhe është njohur nga një numër mjaft i madh shtetesh, në mesin e të cilave janë edhe shumica e superfuqive botërore. Shteti tani ka nevojë për demokraci stabile, ku respektohen rregullat në mënyrë të përpiktë, ku ka politikanë që e dinë se çfarë shteti i duhet zhvillimit

të kësaj demokracie të re, politikanë të dëshmuar në ndonjë sferë të caktuar profesionale, që e dinë se çështje suksesi dhe e mira publike, politikanë të cilët janë në rrjedha të proceseve integruese, të cilët dinë t'i përmbushin kërkesat e sundimit të ligjit, të cilët e dinë rëndësinë e gjyqësorit të pavarur, të cilit dinë ta zhvillojnë vendin ekonomikisht edhe më shumë se sa është i zhvilluar.

Skenës politike kosovare në asnjë mënyrë nuk i duhet të trashëgojë veprime politike të ndonjë shteti fqinjë, si për shembull të Shqipërisë, sepse ato veprime i takojnë të kaluarës dhe duhet me shpejtësi të madhe ta zërë hapin dhe të bëjë politikë moderne dhe bashkëkohore. Asaj nuk i duhen politikanë të tipit “meqë nuk po mundem të arrij unë, do ta prish të tjerën...”

Përveç partive politike, të cilat kanë probleme serioze me profilizimin dhe konsolidimin e tyre, në demokracinë kosovare në gjendje mjaft të rëndë është edhe shoqëria civile në përgjithësi, duke i përfshirë mediet, shoqatat e biznesit, OJQ-të, ku në shumicën prej tyre thuhet ekziston nga një degë e secilës parti parlamentare të Kosovës. Por ajo që është shumë interesante me partitë politike, tani për tani, është se ato e kanë shumë të vështirë të kontrollojnë anëtarësinë e tyre, e aq më vështirë strukturat e tyre nëpër degët e tyre në secilën komunë të Kosovës. Kjo bën që brenda strukturave udhëheqëse të partive politike të ketë persona të cilët mbajnë ndonjë pozitë (anëtar, nënkryetar, kryetar të kryesisë së degës, anëtar i këshillit drejtues të

degës) dhe në të njëjtën kohë punojnë për interesa të ndonjë partie tjetër. Kjo zakonisht ndodh ndërmjet partive, të cilat kanë një rivalitet të theksuar. Kjo e ngre në shkallë të lartë mosseriozitetin e personave, të cilët gjenden në këto pozicione (analizo rastin e fundit me komisionarët e të gjitha partive, a nuk ishin ata persona të strukturave të partive politike dhe të besueshëm të tyre?).

Demokracia kosovare nuk ka fare nevojë për parti politike të tipit dekonstruktiv, të cilat nuk mundin t'i sfidojnë kërkesat të cilat janë të shumta, e në vend që të ballafaqohen me problemin dhe zgjidhjen e tij, përdorin taktika makaveliste dhe retorikë boshe për ta sulmuar kundërshtarin e tyre politik, i cili eventualisht gjendet në rolin e pozitës udhëheqëse me institucionet shtetërore. Kjo formë dhe ky stil nuk është kurrfarë sjellje politike dhe risie në skenën politike dhe në jetën parlamentare të partive politike. Partitë politike duhet të bëjnë një politikë më të arsyeshme dhe kritikata e tyre duhet t'i kenë shumë të argumentuara, sepse janë aq të dobëta dhe të pakuptimta, sa që shpesh po bëhen objekt tallje nga shoqëria dhe model i marrjes së ndonjë shembulli për të keq (analizo retorikën e disa “politikanëve të rinj”, sidomos të opozitës dhe atyre nga shoqëria civile, që ia humbën kuptimin shoqërisë civile).

Në demokracitë e reja, siç është edhe rasti me demokracinë kosovare, kërkohet që skena politike kosovare të ketë politikanë të cilët janë të shkolluar mirë, të përgatitur si në aspektin profesional ashtu edhe atë psikik, të jenë të gatshëm të përballen me sfida të udhëheqjes me institucione shtetërore dhe jo politikanë të cilët bëhen politikanë për një kohë shumë të shkurtër, për arsye se e kanë dikë të fuqishëm atypari nga udhëheqja e partisë, edhe pse nuk i plotësojnë fare as kriteret mesatare për t'u marrë me politikë, veprimtari kjo ndër më të rëndat dhe nuk çajnë kokën fare se nuk e kanë as përgatitjen adekuate shkollore.

Rasti i fundit është shembulli (i keq) më adekuat që mund të na japin ndonjëherë partitë politike, sidomos ato opozitare, të cilat në kuadër të strukturave të



veta mblodhën politikanët e harxhuar të partive të tjera politike, të cilët jo që nuk sollën ndonjë risi, por as që pritët të sjellin, ose të na tregojnë ndonjë performancë të mirë politike as në të ardhmen, sepse u mungon stili, forma, retorika e qartë, karizmi politik, argumentimi në debat, diskutimi konkret, serioziteti në paraqitje publike, përgjegjësia dhe përgjeshmëria politike, njohuritë e përgjithshme dhe konkrete, profesionalizmi, qetësia shpirtërore, durimi për ta dëgjuar tjetrin, replikën nuk dinë ta bëjnë atëherë kur duhet, modestia nganjëherë e tepërt, kokëfortësia në paraqitje publike, presioni psikik ndaj kolegut, arroganca e theksuar e shumë e shumë dobësi tjera (analizo mbushjen me persona të dy partive politike opozitare, njëra mblodhi të pakënaqurit e partive të tjera dhe ndëshkoi të vetët, ndërsa tjetra mblodhi alamet ekspertët e Kosovës E – 15, u zvogëlua në më pak se 7%, d.m.th në vend se të rritej, u zvogëlua..., a thua pse?...).

Rreziku do të jetë edhe më i madh po qe se partitë politike nuk fillojnë me shpejtësi dhe me të vërtetë të sjellin kualitet në strukturat e tyre udhëheqëse, e sidomos në degët e tyre nëpër komuna, sepse në një numër të madh të degëve në shumicën e komunave të Kosovës, partitë politike i kanë degët e tyre në bllokim e sipër. Ato funksionojnë me parime të qeverisjes së fisit dhe kanë në kuadër të tyre grupe oligarkësh, të cilët medoemos duhet të jenë të lidhur në mes vete ose në gjini gjaku, ose gjini krushqie... (analizo përbërjen e kryesive të degëve nëpër komuna të pesë partive politike më të mëdha të Kosovës).

Andaj, mundësinë e fundit për të lëvizur këtë vit përpara dhe për t'i bërë partitë politike kosovare më moderne, më bashkëkohore, më serioze, më kontribuuese, më të reformuara, më të preferuara, më të pasura me kadro profesionale të dëshmuar dhe parti, të cilat e forcojnë dhe e zhvillojnë demokracinë në Kosovë, liderët e tyre duhet të rishikojnë edhe njëherë se kush duhet të jetë dhe kush jo në struktura partiake udhëheqëse, sidomos në kryesitë e degëve të tyre nëpër komuna, sepse demokracia në një shtet i cili ka pranuar sistemin e pluralizmit matet me atë se sa janë të demokratizuara dhe funksionale partitë politike... ■

(Autori është asistent në Katedrën e Shkencave Kushtetuese – Administrative, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës)

BOSNJA DHE HERCEGOVINA, MES HALLEVE DHE SHPRESËS

Reportazh nga Bosnja dhe Hercegovina

Milazim MUSTAFA

Një nga ish-republikat jugosllave, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës përjetoi fundin e saj më të vështirë në rrugën drejt pavarësisë. Në këtë vend u ushtrua dhe u përjetua fatkeqësia më e madhe në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Mbi popullin boshnjak u ushtrua gjenocidi më i rëndë. Ishte ky një turp për botën e civilizuar, para së gjithash, në zemër të Evropës në dekadën e fundit të shekullit të 20-të. Fjalën e kemi, në veçanti për rastin e Srebrenicës, ku mbi 8 mijë veta, burra, kryesisht pleq e fëmijë, u zhdukën nga faqja e dheut për shkak të bindjeve të tyre fetare.

Sot, edhe pse kanë kaluar mbi 15 vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes së Dejtonit, Bosnja përjeton fatkeqësinë e luftës që la gjurmë të thella në gjithçka që gjendet në këtë shtet. Gjithçka në Bosnjë ndahet në periudhën para dhe pas luftës. Përveç gjurmëve të pashlyeshme nëpër zemrat e qytetarëve të këtij shteti, akoma nëpër vende të caktuara hasen edhe gjurmë të plumbave, granatave dhe mjeteve të tjera shkatërruese që në mënyrë figurative tregojnë atë që gjendet në memoriet e banorëve të këtij vendi.

Bosnja “funksionon” në kuadër të një kaosi të gjithanshëm, si në aspektin politik, ekonomik e kështu me radhë. Gjithçka në këtë shtet është gjendje sui generis dhe e gjithë kjo kryhet dhe lejohet para faktorit ndërkombëtar që gjendet në këtë shtet. Të gjithë heshtin,

përpos popullatës së thjeshtë dhe personave që tentojnë ta mbajnë gjallë këtë shtet. Mirëpo, sipas personave të mirëthirrur, kjo është një shpresë e kotë, sepse perspektivë për këtë shtet, në këtë formë të funksionimit, nuk ka. Edhe pse kjo tingëllon në mënyrë shumë pesimiste, por, realiteti është i tillë.

Sa i përket rregullimit të brendshëm, ekzistojnë disa nivele të qeverisjes së këtij shteti. Në nivelin e parë mund ta llogarisim Kryesinë e Bosnjës dhe Hercegovinës (nuk ka kryetar, por ka kryesi), e cila është në rrotacion në mes tre anëtarëve, një boshnjak, një serb dhe një kroat. Secili me rrotacion merr mandatin e kryetarit në kohë prej tetë muajsh (mandati i tyre i plotë është katër vjet). Anëtarët e kryesisë zgjidhen drejtpërdrejt nga popullata. Udhëheqësi i Këshillit të Ministrave emërohet nga kryesia dhe aprovohet nga Parlamenti (Dhoma e Përfaqësuesve). Parlamenti është dydhomësh: Dhoma e popullit dhe Dhoma e përfaqësuesve. Dhoma e popullit përbëhet nga 15 delegatë (nga pesë delegatë prej secilit komunitet), si dhe Dhoma e përfaqësuesve që përbëhet prej 42 anëtarëve, ku 2/3 zgjidhen nga Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, kurse 1/3 nga Republika Srpska.

Fillimisht, sipas Marrëveshjes së Dejtonit, ky shtet ishte i ndarë në dy entitete, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika Srpska. Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës përmban 51 % e këtij shteti, kurse pjesa tjetër i takon Republika Srp-



Pamje nga Mostari – Ura e Mostarit e ndërtuar në vitin 1558, u rrënuar nga forcat kroate në vitin 1993. Nga viti 2005 është nën mbrojtjen e UNESCO-s.



Varri i kryetarit Alija Izetbegović dhe varret e dëshmorëve të luftës së fundit.

skës. (Në vitin 2000 u krijua edhe Rajoni Brčko). Niveli i tretë paraqet ndarjen kantonale. Bosnja dhe Hercegovina është e përbërë prej gjithsej dhjetë kantoneve. Në nivel lokal, që paraqet nivelin e katër, respektivisht ndarja nëpër komuna, gjithsej kemi 137 komuna (74 në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe 63 në Rep. Srpska). Secila nga këto komuna kanë vetëqeverisjen e tyre lokale. Për të qenë edhe më e absurde e gjithë kjo laramani në Bosnjë dhe Hercegovinë kemi edhe katër qytete “zyrtare” (bashki) që janë Banja Luka, Mostari, Sarajeva dhe Sarajeva Lindore.

Përveç kësaj në Bosnjë është prezent edhe Përfaqësuesi i Lartë për Bosnjën dhe Hercegovinën, njëherësh, njeriu më i fuqishëm me fuqi të theksuara legislative dhe ekzekutive, por edhe njeriu më i “famshëm” në këtë shtet (e njohin dhe e dinë me emër edhe fëmijët më të vegjël). Kjo formë e funksionimit është bërë pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të këtij shteti. E gjithë kjo administratë shtetërore thith një pjesë goxha të madhe të buxhetit. Tentativat e liderëve boshnjakë dhe atyre kroatë për ndryshim të sistemit qeverisës, bllokohen nga ata serbë, të cilët frikësohen se do t'i humbasin privilegjet që ua garanton Marrëveshja e Dejtonit.

Në Sarajevën e bukur dhe mbresëlënëse gjithçka është e ndarë. Janë të ndara edhe ëndrrat e qytetarëve të saj. Si vizitor i këtij shteti, po nuk pate informata paraprake për këtë shtet, do të habitesh së tepërmi. Si është e mundur për një gjë të njëjtë të kemi tre ose më shumë versione? Këtë e gjejmë vetëm në Bosnjë. E gjithë kjo varet se me kë je takuar dhe kush ta shpjegon rastin.

Bosnja duket si një shtet vetëm në

aspektin e jashtëm. Përndryshe brenda saj gjithçka është e ndarë. Lufta e fundit ka zhdukur gjithçka që ka pasur të bëjë me bashkëjetesën në këtë vend.

Në Bash Çarshinë e famshme, mjaft mirë të ruajtur dhe konservuar pas luftës së përgjakshme, shihet mjaft mirë historia e këtij vendi. Gjurmët e trashëgimisë osmane janë ruajtur në maksimum. Ashtu siç ruhet edhe identiteti dhe trashëgimia islame nëpër zemrat e popullatës boshnjake. Kjo Çarshi në dalje të saj kufizohet me pjesën tjetër të qytetit, atë të ashtuquajturën pjesa e re, që mban elemente të kulturës dhe civilizimit perëndimor. Sarajeva, si e tillë, më të vërtetë paraqet një urë lidhëse mes kulturave dhe civilizimeve. E gjithë kjo e lidhur në një formë shumë të mirë dhe me një përshtatje të mrekullueshme arkitektonike. Në këtë pjesë gjendet edhe qendra e madhe tregtare e këtij shteti. Është kjo qendra tregtare BBI, që është qendra e parë hallall dhe më e madhja në Evropë. Turistët e shumë habiten kur nuk mund të gjejnë pije alkoolike ose diçka tjetër të ndaluar islamikisht. Kjo qendër është pronë e bankës me po të njëjtin emër, bankë kjo e cila punon edhe sipas sistemit financiar islam.

Edhe qytetarët gjatë prezantimit të tyre janë të ndarë. Si boshnjakë prezantohen vetëm muslimanët. Kurse të tjerët prezantohen si serbë të Bosnjës, respektivisht kroatë të Bosnjës. Boshnjakët e ruajnë me krenari edhe identitetin e tyre musliman, të fituar pas luftës së fundit. Me ëndje e përkujtojnë edhe kryetarin e tyre legjendar, Alija Izetbegovićin, dijetarin, filozofin dhe heroin e madh që vjen nga ky shtet; personalitetin që udhëhoqi procesin e shtetformimit, por edhe pro-

cesin e vetëdijesimit të popullatës së tyre.

Në komunikimin e përditshëm, vërehet lehtë edhe urrejtja ndërfaqetare dhe ndëretnike mes qytetarëve të Bosnjës. Kjo vërehet edhe gjatë prezantimeve të tyre zyrtare. Përfaqësuesit e trupit ndërfaqetar përbëjnë një organ të formuar për të menaxhuar ruajtjen e bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfaqetare në vend. Edhe pse si i tillë funksionon, efektiviteti i këtij trupi mbetet në pikëpyetje. Në një rast ku ishim prezent të dëgjonim për punën dhe veprimtarinë e këtij trupi, nuk mungonin edhe batutat dhe nënçmimet për përfaqësuesin e komunitetit tjetër. Pjesë interesante e këtij trupi është se udhëheqësinë e vet e përbëjnë katër anëtarë: një musliman, një katolik, një ortodoks dhe një hebre. Edhe pse në Bosnjë ka një bashkësi shumë të vogël të hebrenjve (janë më pak se 500 anëtarë), edhe përfaqësuesi i këtij komuniteti ka rastin të jetë me rotacion kryetar i komitetit ndërfaqetar të Bosnjës. Në bisedë me një anëtar të këtij komiteti, dr. Aid Smajić, përndryshe ligjërues në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, i tregoi hallet dhe dertet e popullatës në këtë shtet. Ai, në veçanti, flet për hallet e popullatës muslimane. Në Bosnjë neve muslimanëve na bëhet diskriminim i hapur në të gjitha fushat. Kjo i bie si të jesh shërbëtor dhe rob në shtëpinë tënde”, - thotë doc.dr. Aid Smajić. Edhe në procesin e punësimit ne hasemi me një padrejtësi të madhe që na imponojnë ligjet e Bosnjës. Ta marrim



Pamje nga Bash Çarshia – Sarajevë.

për shembull një ndërmarrje private, e cila i ka të punësuar 6 punëtorë. Prej këtyre gjashtë të punësuarve dy duhet të jenë muslimanë, dy katolikë dhe dy krishterë ortodoksë. Kjo do të ishte në rregull po të ishte edhe pjesëmarrja e përgjithshme në shtet kështu proporcionalisht. Por në këtë shtet, muslimanët janë 50%, kurse katolikët vetëm 13 %. Në këtë rast, padrejtësia më e madhe na bëhet neve muslimanëve. Për këtë shkak edhe përqindja më e madhe e të papunëve janë muslimanë”, - ankohehet dr. Smajiç. Në pyetjen se si e shohin të ardhmen e këtij shteti, prof. Smajiç një intelektual mjaft i talentuar, rrëfëhet duke thënë se vështirë do të kemi ardhmëri me një subjekt si kisha ortodokse serbe që ishte frymëzuesi kryesor i gjitha të zemrave që bëri ushtria paramilitare serbe mbi popullatën muslimane.

Ai tregon edhe për plagët e luftës që akoma hasen në përditshmërinë e qytetarëve të Bosnjës. Pas luftës numri i popullatës muslimane në këtë shtet është zvogëluar për gati se një milion. Kjo është një shifër shumë e madhe, por shumë e vërtetë. Diku mbi 200 mijë veta i mori lufta, por kemi edhe një numër mbi gjysmë milioni që e lëshuan Bosnjën gjatë luftës dhe nuk u kthyen më. Ky është çmimi që paguam gjatë luftës.

Përkundër kësaj gjendje të mjerueshme dhe ardhmërisë së zymtë, në Bosnjë lulëzon jeta kulturore, kurse Sarajeva vazhdon të mbetet vatër e kulturës së mirëfilltë ballkanike, vend ku bashkëjetojnë dhe “luftojnë” mes vete orienti dhe oksidenti. ■



NË SUDAN REFERENDUM, NË TUNIZI DHE ALGJERI TRAZIRA



Misionarë të krishterë që veprojnë në Sudanin jugor, për të cilin është bërë ky referendum

Arsim JONUZI

SUDAN Heshnje e akullt në vendin e vapës. Sudani po kalon ditët më vendimtare të historisë së vendit, ndërsa pritet me ankth rezultatit i referendumit, i cili do të vendosë për ardhmërinë e përbashkët: a të ndahet veriu nga jugu. Siç informon agjencia e lajmeve AP, statusi i rreth 1.5 deri 2 milionë jugorëve, të cilët jetojnë në veri të Sudanit, është një nga pikat kryesore, të cilat duhet të zgjidhen në negociatat mes veriut dhe jugut, nëse Sudani i Jugut, ashtu siç pritet, voton për pavarësi në referendum. Me dhjetëra mijëra jugorë, të cilët mbesin në veri, pa marrë parasysh se për një periudhë afatshkurtër a afatgjatë - janë tejet të shqetësuar. Zyrtarët veriorë kanë theksuar se nëse jugu bëhet shteti më i ri në Afrikë, jugorëve që mbesin në veri do t’iu merret nënshtetësia dhe do të dëbohen nga vendet e punës. Jugorët frikësohen se mund të vihen në shënjestër të veriorëve të hidhëruar. Jugorët kanë arritur gjatë dekadave të kaluara, duke u arratisur nga lufta qytetare mes veriut musliman dhe jugut të krishterë, luftë kjo e cila u kushtoi me jetë 2 milionë njerëzve. Refugjatët mbushën lagjet e varfra, të cilat u ngritën në shkretëtirën përreth kryeqytetit dhe në qytetet e tjera veriore. Agjencia për refugjatë e OKB-së ka theksuar se 120 mijë jugorë janë

kthyer para fillimit të referendumit. Vëzhguesit ndërkombëtarë të referendumit kanë theksuar se riadhesimi është organizuar me nguti nga qeveria e jugut dhe se shumë njerëz tani kanë mbetur të nguajar. Veriorët dhe jugorët janë përlëshur edhe në të kaluarën. Në vitin 2005, pas vdekjes së udhëheqësit të jugut, John Garang, pas rrëzimit të aeroplanit të tij, jugorët në veri protestuan pasi që dyshonin se bëhej fjalë për vrasje. Protesta nxiti përlëshje etnike, si pasojë e të cilave humbën jetën 50 persona. Priifti i kishës katolike të Kartumit, John Denghi, theksoi se kisha e tij është duke u furnizuar me qëllim që të jetë e gatshme nëse shpërthen dhuna dhe njerëzit kërkojnë strehim aty. Shqetësimin po e shtojnë edhe më shumë premtimet e presidentit Omar Al Bashir, i cili ka theksuar se do ta forcojë zbatimin e ligjit islamik, nëse jugu shkëputet. Denghi frikësohet se të krishterët mund të vihen në shënjestër dhe mund t’u konfiskohen pronat e kishës. Por, qeveria dhe zyrtarët e partisë në pushtet theksojnë se frika është e pabazë. Ata thonë se jugorët e punësuar nga qeveria do të largohen nga puna, nëse jugu ndahet. Në anën tjetër, shumë veriorë nuk pajtohen me faktin se mund të humbin një pjesë të madhe të territorit.

TUNIZI Trazirat më të rënda që prej dhjetëra vitesh në Tunizi kanë përfshirë kryeqytetin e vendit, Tuniz. Policia iu



Referendumi në Sudan

përgjigj me të shtëna paralajmëruese dhe gaz lotsjellës qindra të rinjve, të cilët hodhën gurë kundër policëve dhe shkatërruan dyqanet. Iu vu zjarri edhe një banke dhe një ndërtesë qeveritare. Përleshje të ngjashme pati edhe në qytetin Gasrine në perëndim të Tunizisë. Atje humbën jetën katër persona. Në protestat e dhunshme për më shumë vende pune dhe kushte më të mira jetese në mbarë vendin, sipas të dhënave zyrtare, janë vrarë 23 vetë. Aktivistët për të drejtat e njeriut raportuan se numri i të vdekurve është deri 50. Presidenti Zine al-Abidine Ben Ali tha se protestat kontrollohen nga jashtë për t'i sjellë dëm Tunizisë. Ai deklaroi se deri në fund të vitit 2012 do të hapë 300 000 vende pune. Shkollat dhe universitetet janë mbyllur deri në një afat të pacaktuar. Shkaqet konkrete për shpërthimin e dhunës në Tunizi dhe Algjeri janë të ndryshme, por arsyet thuajse janë identike: papunësia, mungesa e perspektivës për të rinjtë

nën 35 vjeç – brez, i cili përbën shumicën e popullsisë në të dy vendet. Të prekur nuk janë vetëm fëmijët dhe të rinjtë e familjeve të varfra, por edhe ata që kanë përfunduar studimet e larta. Si në Tunizi, edhe në Algjeri e Marok ka vite që deviza mbizotëruese është: kush ka mundësi, emigron për në Evropë. Një nga shkaqet e protestave është edhe shtypja politike, marrja nëpër këmbë nga ana e pushtetm-

bajtësve, si dhe korrupsioni. Algjeria nuk është vend i varfër. Ajo bën pjesë ndër eksportueset më të mëdha të naftës dhe të gazit në botë. Por, nga rreth 57 miliardë dollarë fitime nga viti i kaluar, shtresat e gjëra të popullsisë së Algjerisë nuk kanë pasur thuajse asnjë përfitim. Disa ekspertë nuk e përjashtojnë përhapjen e protestave edhe në Marok, ose në vende të tjera. Por, deri tani në mbretërinë e

Marokut nuk ka pasur trazira. Edhe gjendja në Algjeri është qetësuar pak, pasi presidenti i vendit, Abdelaziz Bouteflika, shpalli uljen e çmimit për ushqimet bazë, si vaji dhe sheqeri. Kurse premtimi i presidentit tunizian, Zine el Abidine Ben Ali, se do të hapte 300 000 vende të reja pune, nuk u përmbush dhe kjo çoi në acarimin e protestave. Po ashtu, në Tunizi ekziston edhe censura për mediat. Problem për Algjerinë dhe Tunizinë është mungesa e një alternative të besueshme ndaj sistemit politik aktual. ■



Trazirat në Tunizi

VITI KUR AHMET ZOGU NDALOI FEREXHENË


Kastriot DERVISHI

Në vitin 1937, në Shqipëri hyri në fuqi ligji që ndalonte mbulimin e fytyrës së gruas shqiptare. Për të arritur deri këtu ishin kaluar disa hapa të tjerë që kishin të bënin me reformimin e statuseve të komuniteteve fetare, për të arritur më pas në nivele më të larta të këtyre reformave. Ndonëse ishte një ligj i rëndësishëm, zbatueshmëria e tij ishte në vitet 1937 – 1939. Nisma për heqjen e ferexhesë erdhi nga KMSH-ja, duke pasur një mbështetje të fortë të organeve shtetërore, si në fazën e parë ashtu edhe në zbatimin e ligjit. Më 1 mars 1937, Këshilli i Përhershëm i Bashkësisë Muslimane të Shqipërisë, mbështetur edhe nga kryemyftinitë e Tiranës, Gjirokastrës e Shkodrës, duke u bazuar në shkrimet e shenjta, pohoi se *“asht e ndigjueshme fetarisht hapja e fytyrës dhe e duerve të gruas myslimane dhe si konsekuencë, marrja pjesë e saj në çdo shesh të aktivitetit njerzuer”* dhe mori vendimin për heqjen e mbulesës së ndalimit të fytyrës te gratë. Kjo mbledhje u provokua nga kryemyftiu i Gjirokastrës, Halit Peshkopia dhe kryemyftiu i Korçës, Hafëz Xhaferri. Në motivacionin e rastit thuhej se në vitin e parë të predikimit të Islamit në Shqipëri, mbështetur mbi urdhrin e Pejgamberit, juristët myslimanë të shekullit të parë predikuan zbulimin e duarve dhe të fytyrës. Por më vonë, të tjerë juristë, të shtyrë prej nevojave të tjera, u shtrënguan të vendosnin dispozita ndaluese. Në vijim të raportit përligjës thuhej se atdheu ynë kishte nevojë që edhe grua-ja të merrte pjesë në jetën shoqërore e kulturore të vendit, duke kërkuar zbatimin e zakoneve të mira të kombeve të përparuara. Për këtë, institucioni i sipërpërmendur njëzëri miratoi raportin e kryesisë dhe vuri në dijeni qeverinë, duke i hapur rrugë, më 6 mars 1937, miratimit të ligjit “mbi ndalimin e mbulesës së gruas”. Gazeta “Drita” e 2 marsit 1937 e quante Ahmet Zogun *“psikolog të thellë të popullit të tij dhe largpamës gjenial të nevojave kombëtare”*. Për këtë qëllim gazeta citonte Ahmet Zogun, i cili kishte thënë se viti 1937 do të sillte një tog reformash që do të ishin një fuqi shtytëse për përparim e entuziazëm. Sipas ligjit, kundërvajtësit



gjobiteshin deri 500 fr. ar. Ligji parashi- konte ndëshkime të tjera edhe mbi bash- këshortët, baballarët, etj. Deputetët që mbajtën fjalime ishin Hiqmet Delvina, Fejzi Alizoti, Hafiz Xhemal Dibra, Jashar Erebara, Xhemal Naipi, Ferit Vokopola, Eshref Frashëri, Faik Dishnica, Qani Sulejmani, Hamit Myftiu, Fiqri Rusi dhe Ahmet Hastopalli. Siç edhe shihet nga emrat, deputetët me përkatësi tjetër fe- tare, duke filluar nga kryeparlamentari Evangjeli, kanë preferuar të heshtin. Në një letër që i drejtonte kryeministrit, mbreti Zog vinte në dukje se vendimi i Parlamentit përbënte një *“hap deciziv për naltësimin e nivelit të gruas shqiptare, tue i hap asaj një fushë të gjanë për zhvil- limin e individualitetit të saj për dobi të familjes, shoqënisë e t'atdheut”*. Mbreti porosiste që me një buxhet të veçantë të hapeshin kurse falas kundër analfabet- izmit dhe për mësim të përgjithshme praktike, të zhvillimit moral e mendor.

Zogu kërkonte që t'i njoftohej përfun- dimi i kësaj pune. Ligji për ndalimin e mbulimit të fytyrës së gruas u parapri nga diskutimet e disa deputetëve, të cilët sikurse e thamë më sipër, ishin të gjithë të besimit musliman. -Hiqmet Delvina ka shprehur respektin më të thellë për mbretin Zog, duke shprehur se kjo re- formë nuk do të ishte as e para dhe as e fundit. Sipas tij askush nuk duhej të dys- honte se kjo reformë do të sillte cenimin e gruas shqiptare. -Fejzi Alizoti e ka hapur fjalën e tij se shumë vetë mendo- nin se feja myslimane ishte pengesë për përparimin e kombeve, gjë që sipas tij nuk ishte e vërtetë, pasi jo feja por injo- ranca në bashkëpunim me egoizmin krijuan në disa vende të botës haremet, një sistem të vërtetë robërie në trajtimin e femrës. Sipas tij, nuk mund të kishte asnjë reformë pa filluar nga grua-ja. -Hafiz Xhemal Dibra, kleriku deputet e ka vlerësuar me rëndësi të posaçme pro-



jektligjin në fjalë, duke e mbështetur edhe nga pikëpamja fetare se mosmbulimi i femrës ishte i lejuar. -Jashar Erebara në fillim të diskutimit të tij shprehet se, në shumicën e tij, populli shqiptar nuk kishte qenë i mendimit se gruaja duhej mbuluar. Prandaj populli do ta pranonte me gëzim reformën. Pas kësaj ai sjell shembuj për rastin në fjalë. -Xhemal Naipi, shprehet se në Kur'anin e Shenjtë dhe në fjalët e Pejgamberit Muhamed, thuhej qartas se fytyra e femrës nuk quhej auret (mbulesë). Më tej ai thotë se perçja nuk i ka sjellë asnjë të mirë gruas shqiptare, e sidomos kohët e fundit kur kishte shkaktuar mjaft dëme. Sipas tij, perçja ishte mjet i imoralitetit. -Ferit Vokopola e ka quajtur si shumë të rëndësishëm projektligjin e paraqitur, tek i cili mbizotëronte fryma përparimtare. Ai për këtë çështje citon një filozof indian për çështjen e qytetërimeve lindore dhe perëndimore, duke e mbyllur këtë pjesë me namin e keq të haremeve. Vokopola thotë se shqiptarët

ishin brenda një familje oksidentale, si kombi më i vjetër i Ballkanit. Mbulesën e gruas ai e quan një zakon të huaj. -Eshref Frashëri, ka theksuar se projekti ishte shpëtimtar për vendin, duke sjellë shembuj se mbulesa e gruas më së shumti ishte një çështje që i ishte përzjer fesë. Sipas tij, në Shqipërinë e Zogut nuk mund të tolerohej kjo gjë. Ai thoshte se duhet të shkundeshim nga zakonet e vjetra të Anadollit, të cilat vetë Anadoli i kishte shkundur. -Faik Dishnica pohonte se me këtë ligj do të krijoheshin barazia e domosdoshme shoqërore në vend, duke sjellë një shpëtim për kombin. Sipas tij, kjo reformë nuk fillonte sot, pasi ajo gradualisht kishte filluar prej kohësh. -Qani Sulejmani ka mbështetur kolegun e vet në fjalët që ai sapo kishte thënë duke shtuar se priste të tjera reforma në vend. -Hamit Myftiu e ka quajtur nismë të mirëpritur projektligjin që vinte, duke shtuar se populli shqiptar do ta pranonte me gëzim atë. -Fiqri Rusi e ka trajtuar çështjen edhe nga pikëpamja

politike, pasi për dobinë shoqërore dhe fetare të tij kishin folur deputetët e tjerë. Sipas tij edhe politikisht ligji i ri do të kishte rëndësi të madhe. -Ahmet Has-topalli e ka quajtur projektin e ri vepër madhështore. Duke e pasuruar diskutimin e tij, ai ka sjellë shembuj nga historia. Kanë vijuar edhe diskutimet e Ali Begesë, Salih Vuçiternit e për t'u mbyllur me fjalën e ministrit të Punëve të Brendshme, Musa Juka i cili ka mbrojtur projektin në emër të qeverisë. Miratimi i ligjit për ndalimin e fytyrës së gruas, nuk mund të ishte një veprim që, në tërësinë e tij, do të kalohej pa probleme. Ministria e Punëve të Brendshme që merrej me zbatimin e tij dhe Ministria e Drejtësisë që kishte në varësi bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin Myslyman Shqiptar, ishin vazhdimisht në bashkëveprim me njëra-tjetrën për zbatimin e ligjit dhe për moskrijimin e traumave sociale që mund të lindnin nga zbatimi i këtij ligji. Për ta bërë sa më funksional atë, në radhë të parë u kërkua përpikëri nga nëpunësit e shtetit dhe gratë e tyre. Jo vetëm për lirimin e gruas shqiptare nga skllavëria e mbulesës së fytyrës, por edhe për të ruajtur figurën e klerikut në opinion, KMSH-ja bashkëpunoi ngushtë me MPB-së. Miratimi i ligjit në fjalë i dha mundësi Ministrisë së Punëve të Brendshme të jepte porositë e ndryshme për zbatimin e tij. Nga shfletimi i dokumenteve arkivore del se prefekurat që kanë pasur probleme në zbatimin e ligjit kanë qenë Shkodra dhe Durrësi. Më 1 mars 1937, Zyra Sekrete e MPB-së njoftonte Prefekturën e Shkodrës se Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Musliman bazuar në interpretimin e Kur'anit kishte dhënë fetvanë për zbulimin e duarve dhe fytyrës së grave. Në porosinë e rastit për prefekturën, Zyra Sekrete udhëzonte se elementët fanatikë mund të përkraheshin në këtë rast nga propaganda jugosllave, duke kërkuar moslejimin e një gjëje të tillë dhe për këtë të njoftohej mënyra e veprimit (AQSH, F. 152, V. 1937, D. 157, fleta 1). Aktivizimi i propagandës jugosllave shënohej si më aktiv në brezin kufitar të qarqeve të Shkodrës, Dibrës e Kukësit. Më 2 dhe 4 mars të vitit 1937, prefekurat e Shkodrës, Gjirokastrës dhe Elbasanit urdhëroheshin të propagandonin vendimin e komunitetit në fjalë. Elementët fanatikë duke mos pëlqyer reformën e ndër-marrë kanë kaluar në veprime kë-



Mbreti Zog, me gruan Xheraldinën dhe me disa shehlerë bektashinj

cënuese ndaj autoriteteve më të larta fetare të Shkodrës. Zëvendës prefekti i Shkodrës, Daut Çarçani, më 4 mars 1937, njoftonte autoritetet se çështja e zbulimit të grave ishte objekt bisedimi në atë qark dhe kishte sjellë tronditje, por nuk shihej ndonjë propagandë me prirje të rrezikshme. Më 8 mars të vitit 1937, Zyra Sekrete porosiste prefekturat e vendit, veçanërisht ato të Dibrës e Kosovës, që të interesoheshin pranë organizatës "Gruaja Shqiptare" me rastin e votimit të ligjit, t'i dërgonin telegrame mbretit, parlamentit, qeverisë dhe një kopje gazetës "Drita". Aty ku nuk ekzistonin organizata grash, këtë ta bënin gra nga paria. Zëvendës prefekti i Durrësit, Mahmut Golemi, njoftonte se zonja nga paria do të dërgonin nga Durrësi, Kavaja, Kruja, Shijaku. Prefekti i Elbasanit Sadik Metra, më 16 mars 1937, njoftonte se me të mbërritur urdhri për zbulimin e fytyrës, ishin ftuar të gjithë nëpunësit e atyshëm dhe u ftuan të zbatonin ligjin me gratë e tyre, gjë që ishte zbatuar prej një jave. Vihej në dukje se myftiu i Elbasanit ishte pro lëvizjes dhe e përkrahte atë. Për vetë kuptimin e çështjes porositej që zbatimi i ligjit të bëhej me shumë takt dhe me shumë kujdes. Kjo në mënyrë që të mos krijoheshin probleme që do të mund të merreshin në opinion si cenim i figurës së grave. Veçanërisht xhandarmëria u porositi të ishte e kujdesshme në zbatimin e ligjit e tregimin e taktit. Më 24 mars 1937, Zyra Sekrete e MPB-së i dërgonte

telegram prefekturave, veçanërisht atyre të Dibrës e Kosovës, se të nesërmen, datë 25, ligji hynte në fuqi e për këtë kërkohej lajmërimi i popullit me kryepleqtë, etj., por kurrsesi me tellall, pasi me këtë mënyrë mund të krijoheshin efekte tallëse. MPB-ja kërkonte që të shtoheshin parullat në mënyrë që populli të bindej se do të zbatohet ligji. Udhëzimi ishte se kur shihej ndonjë grua e mbuluar të mos zbulohet në publik, as të mos komunikohet me të, por të bëheshin hetime fshehtas. Më 25 mars 1937, prefekti i Shkodrës, Javer Hurshi, njoftonte se asnjë grua nuk kishte dalë e mbuluar. Një pjesë e grave kanë kaluar me karrocë me fytyrë të zbuluar. Dy ditë më vonë, Zyra Sekrete kërkonte nga prefekturat, veçanërisht ato të Shkodrës, Tiranës, Dibrës e Kosovës, se si kishte shkuar dita e kush kishte vepruar kundër ligjit, duke kërkuar zbatimin e ligjit, në mënyrë për të arritur qëllimin që asnjë grua të mos dilte e mbuluar. Më 27 mars 1937, zëvendës prefekti i Vlorës, Kamber Qafmolla, njoftonte se asnjë grua nuk kishte dalë e mbuluar. Të njëjtën gjë thoshte edhe prefekti i Elbasanit, Sadik Metra. Zëvendës prefekti i Durrësit, Mahmut Golemi, njoftonte po atë ditë se asnjë grua nuk ishte parë e mbuluar, por lëvizja jashtë banesave kishte qenë e kufizuar. Sipas tij, kjo rridhte nga mungesa e veshjeve pasi shumica ishin të varfra. Edhe prefekti i Beratit, Qazim Bodinaku, njoftonte për sukses të ligjit. Më 5 prill 1937, prefekti i Beratit, Qazim

Bodinaku, njoftonte se ligji ishte pritur me gëzim të madh në popull dhe nuk ishte shënuar ndonjë kundërvajtje. Vetëm në Fier dilnin dy gra. Të dy burrat e tyre ishin thirrur dhe kishin kërkuar falje se nuk e dinin që atë ditë kishte hyrë ligji në fuqi. Më 12 prill 1937 doli qarkorja ku thuhet se duke çmuar se reforma e zbulimit të fytyrës thyen një zakon të keq të rrënjësor e të zbatuar për një kohë të gjatë, MPB-ja kishte gjykuar të nevojshme që në ditët e para të mos kërkohej ashpërsisht zbatimi i ligjit, duke filluar me butësi e tolerancë, por duke qenë se prej ditës së zbatimit të ligjit nuk kishin dalë gra të mbuluara, tani kërkohej zbatim më i rreptë i ligjit. Në qarkoren tjetër thuhej se ishte vërejtur se shumë gra kishin bërë zbulim të pjesshëm të fytyrës, duke e zënë ballin e gushën deri te goja, ndërsa disa të tjera pa qenë nevojja përdornin çadra, me të cilat maskonin fytyrën. Kërkohej që këto raste të konsideroheshin në kundërshtim me ligjin. Nga ana tjetër kërkohej nga xhandarët të kishin sjellje korrekte, duke u sjellë me urtësi e xhentesë, e në rast nevojë të jepeshin edhe këshillat e rastit. Reforma e vitit 1937 dhe disa të tjera të planit fetar që kishin ngelur të pazbatuara u zbatuan rreptësisht deri në 7 prill 1939. Duke përfutur nga ndryshimi i regjimit në vend, u gjet rrugë që ferexheja të ripërdorej. Këtë "tolerancë" fetare, autoritetet fashiste do ta kuptonin më vonë kur ferexheja do të përdorej si mjet maskimi edhe për meshkujt. ■ (55)

PSE NJERËZIT E MEDIEVE E KANË SHUMË GABIM PËR ISLAMIN DHE CILI ËSHTË ÇMIMI?

John L. ESPOSITO

Disa ditë më parë, nikoqiri i një radiotelevizioni kontrovers Glenn Beck, në një paraqitje shokuese injorante (bile edhe fanatike), kishte përzgjedhur një numër të imagjinuar nga mendja e tij duke deklaruar, pa ofruar asnjë provë, se 10% e të gjithë muslimanëve (që nënkupton 150 milionë) janë terroristë që duan ta përmbysin qeverinë e SHBA-së. Beck është shumë i mençur për të qenë kaq budalla! Por, natyrisht, ai është aq i mençur të dijë se do të përfitojë shumë vëmendje prej audiencës që e përcjell në media e internet. Komentet e Beck-ut nuk janë të parat që ai dhe njerëz të tjerë të mëdhenj të medieeve kanë thurur përralla që muslimanët, si grup, duan ta shkatërrojnë Amerikën. Efekti grumbullues i retorikës kundërvënëse të Beck-ut, Bill O'Reilly-it, Sean Hannity, Bill Maher-it, Rush Limbaugh-it, Michael Savage-it dhe shumë të tjerëve, që punojnë shumë dhe pandërprerë duke e portretizuar Islamin dhe muslimanët të kundërt fundamentalisht, kontribuojnë në një kulturë të njohur që i shohin 1.5 miliard muslimanë si armikun potencial. Sondazhet e fundit tregojnë se më shumë se 45% e amerikanëve besojnë se gjendja e konfliktit me shoqëritë muslimane ka për bazë identitetin (veçanërisht, i rrënjosur qoftë në fenë ose kulturën e tyre). Por të dhënat e vërteta e të verifikuara tregojnë se kjo është tërësisht e gabuar! Një sasi masive e të dhënave nga sondazhet e Gallup-it, PEW-it, Zogby-it dhe nga hulumtimet e tjera demonstrojnë se

shkaktarët primarë të dhunës dhe terrorizmit janë gabimet dhe padrejtësitë politike – jo kultura dhe feja. Pse ky fakt është i rëndësishëm? Sepse sondazhi i fundit i Gallup-it, "Matja e gjendjes së marrëdhëniesve muslimanë-Perëndim: 'Vlerësimi i një fillimi të ri,'" i cili konfirmoi se ata që mendojnë se rrënjët e tensioneve muslimanë-Perëndim janë politike, dëshmon se ka gjasa që këto tensione të jenë të shmangshme. Ata që i shohin këto tensione në baza fetare, besojnë se tensionet janë të paevitueshme. Prandaj, nëse konflikti kornizohet si "politik", njerëzit e shohin dhe janë të gatshëm që të punojnë për ta gjetur një zgjidhje.

Një studim i bazuar në hulumtime analitike, i kryer në 55 shtete, prej vitit 2006 deri në fillim të 2010-s, tregon se janë gjetur më shumë se 6 në 10 muslimanë të kenë thënë se Bota Islame e respekton Perëndimin, por rreth gjysma e tyre thonë se Perëndimi nuk i respekton ata. Dhe kanë të drejtë. Në SHBA, 53% e publikut amerikan thonë se nuk e respektojnë Botën Islame. A nënkupton kjo një përplasje të paevitueshme, apo është një zgjidhje? Shumica e muslimanëve kanë shprehur shqetësimin e tyre të thellë për mungesën e respektit, por prapëseprapë kanë ofruar zgjidhje pozitive: ndalojeni përdhosjen e Kur'anit dhe të simboleve fetare, trajtojini muslimanët në mënyrë të drejtë në politikën që ndikon ose ka lidhje me ta dhe portretizojini karakteret islame në mënyrë të saktë në media.

Ndonëse komentuesit dhe analistët e medieeve debatojnë për muslimanët

se janë të shtyrë ose të udhëhequr nga një urrejtje irracionale ndaj amerikanëve, në fakt, shumica e vendeve islame edhe duan marrëdhënie më të mira me Perëndimin, edhe thonë se marrëdhëniet e këqija vijnë nga realiteti politik (prezenca e forcave amerikane në vendet islame, përkrahja e pakushtëzuar e SHBA-së për okupimin izraelit, etj.) – dhe për këtë arsye problemi ka zgjidhje. Si pasojë e përpjekjeve të pareshtura të sojit të Beck-it dhe O'Reilly-it, shumë amerikanë po zhvillojnë një frikë dhe urrejtje jo tolerante dhe irracionale ndaj muslimanëve. Këtë, më së shumti, e kemi të qartë dhe e shohim gjatë debatit për Parkun 51 (vendi ku synohet të ndërtohet Qendra Islame në Nju Jork). Kjo qasje e gabuar mediale po krijon një identitet me bazë konfliktuoze saqë politikanët kryesorë, si Newt Gingrich, i barazojnë muslimanët me nazistët. Ata që marrin pjesë, ose mbështesin protestat kundër ndërtimit të xhamive, djegies së Kur'anit dhe dhunës kundër muslimanëve të pafajshëm, burrave, grave dhe fëmijëve, shfaqësojnë urrejtjen e tyre duke besuar në pazgjidhshmërinë e identitetit me bazë konfliktuoze, përplasjen e kulturave ose të Krishterimit dhe Islamit.

A nuk do të ishte ironi tragjike nëse ne – amerikanët – kemi bërë konflikt të dhunshëm me shoqëritë islame dhe kemi bërë kompromis me liritë civile të qytetarëve muslimanë amerikanë duke i bërë të paevitueshme të gjitha, përderisa e shohim vetveten si viktimë të pafajshme ose të urreyer irracionalisht? A e kuptojnë a jo, kjo që po bëjnë soji i Beck-ut dhe O'Reilly-it, si disa predikues të urrejtjes në botën islame, po punojnë aq shumë saqë po bëjnë që urrejtja dhe konflikti vërtet të ndodh. ■

John L. Esposito është profesor universitar dhe drejtor themelues i Qendrës për Mirëkuptim Islamo-Krishter. Ai është bashkautor, me Dalia Mogahed-in, i librit "Kush Flet për Islamin?: Çfarë mendojnë në të vërtetë një miliardë muslimanë" dhe është autor i librit "E ardhmja e Islamit" (2010).

Revista 'Paqja' ka leje për t'i botuar shkrimet e prof. Esposito-s, pasi ka arritur marrëveshje të drejtpërdrejtë me profesorin.

Përktheu: Osman D. GASHI



John L. Esposito



Alkooli etilik (Etanoli)

Mr. ph. Gzonit SALIHAIJ

Alkooli i cili përftohet nga fermentimi i karbohidrateve të ndryshme (sheqernave të frutave te ndryshëm) përmban alkool etilik.

Në aspektin toksikologjik (helmues) paraqet interes të madh, jo për faktin e numrit të madh të vdekjeve që shkakton ky helm, por për faktin e pasojave shoqërore dhe shëndetësore që lindin nga ky helm, si nga inhalimi i avujve të tij në industri dhe përdorimi i tij si zbutës dhe, në veçanti, rëndësi ka përdorimi i tepruar i pijeve alkoolike në jetën e përditshme që shkakton helmim (dehje) të shpeshtë.

Etanoli bën pjesë në grupin e lëndëve narkotike.

Pas konsumimit të tij, ai në fillim e eksiton dhe më vonë e frenon dhe paralizon sistemin nervor qendror.

Alkooli etilik i konsumuar në doza të larta për një kohë të gjatë mund të shkaktojë sëmundje të rënda organike të sistemit nervor, traktit gastrointes-

tinal, sistemit kardiovaskular, mëlçisë me ç'rast është nga shkaktarët kryesorë të mëlçisë dhjamore etj.

Me helmimet akute me etanol zakonisht vihen re tri shkallë të helmimit (dehjes).

I. Në këtë shkallë ndodhë eksitimi psikomotor, pulsi shpeshtohet, fytyra skuqet, sytë marrin një shkëlqim të veçantë, i dehuri bëhet më i lëvizshëm, fillon të flasë shumë, etj.

II. Në këtë shkallë mbizotërojnë fenomenet e deprimimit, lëkura bëhet e zbehtë, shtohet sekretimi i gjëndrave të djersës dhe të pështymës, frymëmarrja bëhet më e shpeshtë, të folurit nuk ka lidhje logjike, lëvizjet janë të pakoordinuara, I dehuri ka raste që sulmon, shan, qesh, qan etj. Në këtë shkallë, ai nuk kontrollon më veprimet e tij dhe mund të kalojë në akte krimi.

III. Në këtë shkallë i dehuri bie në gjumë të thellë që kalon në komë, temperatura e trupit ulet, pulsi dhe frymëmarrja ngadalësohen, pupilat nuk reagojnë dhe janë zakonisht të zmadhuara, të vjellat vazhdojnë.

Vdekjet nga helmimet akute janë jashtëzakonisht të rralla dhe shkaktohen nga dobësimi i muskujve të frymëmarrjes dhe nga të vjellat.

Doza minimale vdekjeprurëse e alkoolit etilik është rreth 7g/kg peshë trupore e marrë brenda një kohe mjaft të shkurtër. Për një person me peshë 70 kg i bie të konsumojë 1.4-1.5L me koncentrim 40% për një kohë mjaft të shkurtër, që të arrijë dozën minimale vdekjeprurëse.

Thithja e alkoolit etilik nga organizmi dhe kalimi i tij në gjak ndodh përmes difuzionit gjatë traktit gastrointestinal. Ky difuzion është mjaft i shpejtë: 80-90% e sasisë së alkoolit të marrë thithet në rreth 30 minuta, ndërsa 100% thithet për një orë e tridhjetë minuta.

Studimet e bëra nga autorë të huaj në rreth 6000 kufoma alkoolike, shumicës së të cilave u dihej historia e vdekjes, arritën në përfundimin se përcaktimi i përqendrimit të alkoolit në tru është një e dhënë mjaft e vlefshme për të treguar shkallën e dehjes (helmimit). ■

Nr.	Shkalla e dehjes	Përqindja e alkoolit në tru	Efekt i fiziologjik
1	Gjurma	0.005-0.02	normal
2	+	0.02-0.10	normal
3	++	0.10-0.25	humbje e sensit të kujdesit
4	+++	0.25-0.40	Humbje e sensit të ekuilibrit
5	++++	0.40-0.60	Humbje e logjikës, dehje, komë

IDENTITETI I VETMISË POETIKE

Sali Bashota: Sytë e vetmisë, Rozafa, Prishtinë, 2010

Flamur MALOKU

Sali Bashota në librin me proza poetike "Sytë e vetmisë" në planin tekstual e ruan rendin e formimit të tekstit, pra rendin e figurshëm. Rendi poetik e rizbulon tekstin në kujtesë, ndërsa teksti e rizbulon Unin personal në shkrim.

Tri formulimet e jetës: **Ringjallja / Zjarri / Rruzullimi**, hapin tekstin, dialogun e teksteve ndër vete, duke krijuar shkrimin për të marrë edhe statusin e sistemit poetik të dashur. Pastaj, për të dalë edhe në tituj të figuruar jete.


Titujt e dashur janë kratilian. Ata pëlqehen konceptualisht/empirikisht, të cilët rigjejnë e rizbulojnë shpirtin e përplasur në Ringjallje / Zjarr / Rruzullim. Vetë përzgjedhja e titujve hap shkrimin e jetës, figurën e zemrës. Aty ku ringjallet shpirti i tendosur, ringjallet vetmia universale, sytë e flakëruar të subjektit, që tanimë kanë shijuar ringjallje, zjarr e rruzullim.

Motivimi i titujve personalë hyn brenda tekstit të jetës si rigjetje e dramës së gjakuar, si përhershmeri, por edhe si shenjë e ecjes empirike ku mbahet e fortë shenja e përjetimit, bashkë me jetën e shprishur. Jeta zbulohet nëpërmjet diskursit të prozave poetike, duke kushtëzuar përherë emocionin e pikëllimin. Kështu, secili shkrim në hapje ruan emocionin e unit. Tash, subjekti dashurisht rrëfen për fijet e mallit, duke rizbuluar pikëllueshëm sytë e vetmisë së shprishur.

1. Ringjallja

Ringjallja është formulim e figurim që i përshtatet shpirtit, shkrimit. Edhe pse në ringjallje shpirti nuk i shpëton vetmisë, ai tash rivuan përsëri. Kujtimet janë aty, si përherë, të hidhura e të nëmura. Shkurt, lidhja është e gjallë, kujtimet janë të gjalla. Autori rikthehet e shpërthen në kujtime, ndërsa kujtimet shpërthejnë vetminë e ringjallur, që shijohet empirikisht deri në pafundësi.

Gjithçka ringjallet në zinë e nëmur të jetës, duke dalë përherë si shenjë e brendshme që përfaqon mallin infinit. Malli ruan shpirtin e ëndërrimtarit të përher-



shëm, çdoherë në kërkim të prehjes infinite. Lidhjet e këtilla figurative rimarrin afër vetes ndjeshmerinë e thellë, vajin e thellë personal, dramatikën e thellë.

Trishtimi i subjektit brenda dhe jashtë e hap dëshminë e jetës së djegur, që tash rithuret emocionalisht. Këtu ela-

borohet ndjenja si asnjëherë më parë. Aty ku është subjekti, aty është shkrimi, bashkë me klithmat e përjetuar 'Atëherë' e 'Tash'. Kjo, në esencë, e sforcon figurën universale, çdo herë përballë shpirtit të mërztitur, për të vazhduar edhe më tej te rendi i rrëfimit personal.

Duke qenë shkrim për jetën, rendi i rrëfimit të tekstit bëhet rend i kthimit në identitetin e vetmisë. Aty subjekti fillon e pasqyron shpirtin e tij. Autori i rikthehet me mall e vetmi. Kujtimi i dashur është aty, bashkë me dashurinë që natën vonë paraqitet si hije e trazuar në rrafshin kontrativ, si gëzim e vuajtje.

Në secilin variant ruhet e përjetohet koncepti i identitetit të vetmisë. Ajo tash del edhe me tituj të veçantë shkrimi: *Qyqja e katundit tim, Pasqyra, Vaji, Uji i syve, Legjenda, Urata* etj... Këta tituj janë shenjë e figurë në ringjallje të kujtimit shpirtëror. Ringjallja shpirtërore vazhdon rrëfimin, për t'u shtresuar në zjarrin që hapet nga dhembja e universalizohet nga dhembja e preکشme jetësore.

2. Zjarri

Figura e zjarrit e mban tekstin, emocionin e brishtë personal. Zjarri, figurë shkatërruese, tash e prish ekuilibrin e jetës, e prish gëzimin e shpirtit. "Zjarri tashmë është shenjë pasqyrimi, realitet i hidhur, shenjë që lidh kohë e shpirt të vrarë të subjektit (1998). Vendlindja shkatërrohet bashkë me dorëshkrimet e lëna". Njeriu i letrave tashmë rikujton kohën/kaosin, dorëshkrimet e djegura të jetës. Britmat e fjalëve shndërrohen në dhembje reale në pamje reale, ku brenda esencializimit të shpirtit do të shtresohen në klithmë. Gjithsesi, tmerri, lemeria ishte aty në vendlindje, ku hija e vdekjes mbizotëronte. Kështu, teksti 'Gjaku i dorëshkrimeve' lexohet si klithje e dëshpërim, vetmi e melankoli, atëherë e tash në kujtim:

Kur përmbysesj britma e fjalëve brenda nuancave të dhembjes, si gjithnjë klithma shndërrohej në realitet. Nga habia e shikimit pikëçuditësen e melankolisë e kishte zënë gjumë i rëndë mbi ironinë therëse të natës. Tashmë edhe gjaku i dorëshkrimeve ndryshkej në vullkanin e fjetur në vetminë pa emër, pa trajtë, pa shenjë në një stinë tjetër të melankolisë.

Gjaku tash është figurë e përjetuar. Dorëshkrimet e djegura marrin simbolikën e gjakut të Shpirtit/Trupit. Vetmia nga kujtimi tashmë nuk ka emër, as trajtë. Në secilën stinë të jetës është melankolia e brishtë metaforike, kujtimi i trishtuar. I tillë është edhe teksti 'Vetëm Zoti e dinte', që pashmangshëm riartikulon temën e Trishtimit/Vetmisë, ku pasqyrohet ballafaqimi me vdekjen, me shkatërrimin e fundin:

Qielli lotonte si foshnjë e lazdruar.



Për një çast çdo gjë merrte fund. Vetëm Zoti e dinte.

Ky çast i përjetuar në tekst e klithmë, zhvillohet në nuancat e shenjave, duke dhënë formulimin e figurshëm, që shenjohej edhe si titull cikli 'Zjarri', ku shenja e zjarrit del shenjë e ashpër e subjektit përjetues.

3. Rruzullimi

Formulimi 'Rruzullimi' bëhet i rëndë për artikulesin, ku edhe figurat përcjellëse të teksteve bëhen të rënda. Vija tekstore e tematike e 'Rruzullimit' artikulon dashurinë. 'Ajo' tanimë ka humbur në trishtimin e vetmisë së dashur, madje asgjë nuk deklarohet pos tashmë vuajtja e syve. Tekstet e gjuhës së flakëruar janë tekste që bëhen 'Një' për dashurinë. Kështu, subjekti hyn në tekstin dramatik të jetës, në përjetimin e dhembshurisë. Përherë mbretëron gjendja e frikës, përherë mbretëron shenja e trishtimit, e humbjes përjetë. Andaj, te ky cikël rikthehet subjekti bindshëm në emocionalitet, në dëshmi, që hapet si kërkim për komunikim, karshi gjendjes së tendosur. Ky është pozicion që shihet në secilin rrafsh të figurave. Teksti bëhet shenjë e përherëshme, pse jo edhe e përjetshme në shkrim. Sytë e vetmisë shohin parajsën e kërkuar, ndërsa kafshimet mbesin bimë të egra. Shenjat mbartin tonin e thellë, që lidhen e konotohen në infinit. Pra,

këtu shqiptohet vetja si vaj e trishtim për dashurinë:

Sa të ëmbla ishin gjymtyrët e trupit tënd Fytyra e bardhë që kishte krijuar rruzullimin e shpirtit në parajsë.

Këtu shenjtërohet çdo gjë. Kujtimi për dashurinë përcillet krejt i veçantë, përherë i përplotësuar me formulime, që dalin si shenjë e shenjim për mitizim. Aty është dashuria e mbyllur në heshtje e vetmi. Sytë e kërkuar e të vetmuar janë larguar e tretur përjetë.

Dalje

Tri formulimet Ringjallja/Zjarri/Rruzullimi japin nyje figurimi të sistemit, përballë identitetit të vetmisë personale, ku në secilin formulim është artikulimi i konstatuar shpirtëror, nyja shpirtërore. Në nyje provohet shkrimi i dashur. Shenjat e provuara jetësisht japin vetëdije poetike. Sistemi poetik, bashkë me temat e provuara empirikisht si Vetmia/Dashuria/Jeta/Vdekja, artikulojnë bindshëm në prozën poetike "Sytë e vetmisë".

Sali Bashota në rrjetin kategorial rikthen në shkrim kohën e vjetër, pra rikthen rrjetin e kujtimeve, duke ruajtur përherë një kohezion të sistemit poetik. Prandaj, proza poetike "Sytë e vetmisë" vjen ndryshe në letërsinë shqipe, si fuqi kohezioni, si rrjet i sistemuar poetik. ■

EPOSI I KRESHNIKËVE, IDENTITETI

Intervistoi: Besime RRUSTEMI

Profesor Zymer Neziri, këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, që nga viti 1971, është ndër studiuesit më të shquar të folkloristikës shqiptare. Kontributi dhe puna e palodhur e prof. Zymer Nezirit, disa dekada me radhë për këngët epike, sidomos për Eposin e Kreshnikëve, në mbledhjen dhe në studimin e tyre, të botuara në disa vëllime, tashmë janë vlerë identifikuese e trashëgimisë sonë kulturore e shpirtërore brenda dhe jashtë vendit. Pjesëmarrja e prof. Nezirit në shumë simpoziume shkencore, me karakter ndërkombëtar, përfshirë edhe simpoziumin shkencor ndërkombëtar të Universitetit të Harvardit në SHBA, ishte një ndër temat e bisedës sonë.

PAQJA: Z. Neziri, në fund të vitit që lamë pas, Universiteti i Harvardit në

Kembrixh të SHBA-ve organizoi simpoziumin shkencor ndërkombëtar, e nga ata që morën pjesë me kumtesë ishit edhe ju. A mund të na thoni diçka për revistën 'Paqja' rreth pjesëmarrjes suaj në këtë simpoziumin shkencor?

NEZIRI: Në simpoziumin shkencor ndërkombëtar të Universitetit të Harvardit, Kembrixh, SHBA: «Këngëtarët dhe rrëfenjat në shekullin e 21-të: Trashëgimitë e Millman Perit (Milman Parry) dhe të Allbert Llordit (Albert Lord)», që u mbajt nga data 3 deri më 5 dhjetor 2010, në Kembrixh, mora pjesë me një kumtesë. Kumtesën e kemi paraqitur bashkërisht me etnomuzikologun Nikolla Skalldaferrri (Nicolla Scaldaferrri), profesor në Universitetin e Milanos. Titulli i kumtesës është: «Nga arkivi në terren: Hulumtim i ri për këngët epike shqiptare».

Punimet e simpoziumit i shpalli të hapura David Elmer (Dejvid Ellmer),

përgjegjës i kë-shillit përgatitor të këtij simpoziumi të Universitetit të Harvardit. Ai u dëshiroi të pranishmëve mirëseardhje dhe foli për organizimin dhe mbajtjen e këtij tubimi shkencor, në shenjë të përvjetorit të punës së profesorëve Peri dhe Llord në Ballkanin Perëndimor, në vitet 1933-1935, kurse për idenë e mbajtjes së simpoziumit (2007) e falënderoi Zymer Nezirin.

PAQJA: Z. Neziri, cilët nga studiuesit u paraqitën në këtë simpozium?

NEZIRI: Në simpoziumin shkencor ndërkombëtar të Harvardit u paraqitën me kumtesa 32 studiues nga SHBA dhe nga qendrat e njohura studimore dhe universitare të botës (Amerikë, Azi dhe Evropë).

PAQJA: Cilat ishin temat e diskutuara në këtë simpozium shkencor ndërkombëtar?

NEZIRI: Në këtë simpozium shken-



David Elmer dhe Zymer Neziri në koleksionin e Millman Parry-t

TET KULTUROR I SHQIPTARËVE



Zymer Neziri në koleksionin e Milman Parry-t para dollapit me 3500 pllaka të inçizuara në Ballkanin Perëndimor

cor ndërkombëtar, kushtuar M. Perit dhe A. Llordit, u trajtuan këto grupe temash: Formula e tema, Homeri, Epika e Ballkanit, Qasje krahasuese I dhe II, Teknologji, Traditat skandinave, Kujtesë, Muzikë dhe performancë, Qasje bashkëbisedore, Epika dhe shoqëria.

PAQJA: Z. Neziri, a kishte edhe kumtesa në rrafshin krahasues?

NEZIRI: Zgjuan interesim edhe kumtesat në rrafshin krahasues. Në kuadër të traditave skandinave u lexuan këto kumtesa: profesori nga Suedia, Lars Lönnroth (Universiteti i Göteborgut), "Tekstet e vjetra nordike si performancë"; profesoresha Gísli Sigurdsson (Universiteti i Islandës), "Historiku gojor i Edave dhe i Sagave" dhe profesori Thomas A. DuBois (Universiteti i Pensilvanisë), "Malli i parakohshëm për multimedia."

PAQJA: Cilat ishin temat e diskutuara për epikën e Ballkanit?

NEZIRI: Në grupin e temave për

Ballkanin u paraqitën këto kumtesa: profesor John Miles Foley (Universiteti i Misurit), "Epika gojore në Stollac: Tradita kolektive dhe arti individual"; Mirsad Kunić (Universiteti i Tuzllës), "Vdekja e heroit Mustaj Beg i Likës në këngët e Koleksionit të Millmen Perit"; profesoresha Ronelle Alexander (Universiteti i Kalifornisë, Berkeley), Zymer Neziri, "Nga Arkivi në terren: Hulumtim i ri për këngët epike shqiptare."

Pra, në kuadër të epikës gojore të Ballkanit, u shqyrtua edhe epika jonë, në kumtesën tonë, "Nga Arkivi në terren: Hulumtime të reja për këngët epike shqiptare," të përbashkët me prof. Nikolla Skalldaferrin. Kumtesa u prit mirë. Pati edhe diskutime lidhur me të.

PAQJA: Z. NEZIRI, a mund të na përshkruani në pika të shkurtra përmbajtjen e kumtesës suaj?

NEZIRI: Në këtë kumtesë u tha: tradita epike legjendare e Eposit të Kreshnikëve është një pjesë e rëndësishme e

identitetit kulturor shqiptar, e mbledhur kryesisht në anën veriore të Shqipërisë, në Kosovë, në viset shqiptare në Maqedoni, në Serbi e në Mal të Zi. Hulumtime të rëndësishme janë kryer në kaluarën në këtë traditë: ku veçohet edhe puna e Millmen Perit dhe e Allbert Llordit, krahas mbledhësve të tjerë ndërmjet dy luftërave botërore, si dhe më vonë, të nxitur nga institucionet vendore, si Instituti i Kulturës Popullore i Tiranës dhe Instituti Albanologjik i Prishtinës. Këto materiale të ofrojnë një pikë të rëndësishme referimi edhe për kërkime të reja. Sot, këngëtarët janë ende aktivë në rajonet e përmendura, veçanërisht në disa vise specifike, sidomos në Rugovë dhe në disa krahina të Malësisë. Në kërkimet e reja, që zbatohen në këtë fushë gjatë viteve të fundit, duke pasur parasysh edhe koleksionet e vjetra, si dhe me mbështetjen e teknologjive të reja, po bëhen përpjekje për të arritur rezultate të reja të rëndësishme, duke u përqendruar veçanërisht në pikat e

mëposhtme: informacione të reja dhe të dhëna etnografike lidhur me rapsodët e tashëm, sidomos në lidhje me këngëtarët e dokumentuar në pjesën veriore të Shqipërisë, nga Allbert Llordi, më 1937. Vërejtjet analitike për elementet strukturore të vargut, modaliteti i performancës, sidomos aspektet e recitimit të vargjeve dhe aspektet melodike; botimet dhe ribotimet e këtij lloji të epikës legjendare në 15 vjetët e fundit; interesimi i shtetit për traditën epike sot dhe kuptimet që ai do të marrë, veçanërisht në Kosovë, në kuadrin e pavarësisë të vitit 2008; debati për Listën e UNESCO-s të trashëgimisë kulturore; konferenca shkencore ndërkombëtare për Eposin e Kreshnikëve, në Prishtinë, më 2010, ku morën pjesë 100 studiues, etj.

PAQJA: Cili është komenti juaj, për fund?

NEZIRI: Fondi arkivor i këtij universiteti, shumë i njohur në SHBA dhe në botë, i incizuar në 3500 pllaka, i krijuar në vitet '30 të shekullit të kaluar, me emrin Koleksioni i Letërsisë Gojore i Millmen Perit, përveç epikës boshnjake, ka edhe epikë shqipe, kroate dhe serbe. Kënga shqipe është nga pjesa veriore e Vilajetit të Kosovës, nga Sanxhaku i Pazarit, nga vinin edhe lahutarët më të mirë të këtij koleksioni, Avdullah Zeneli dhe Salih Uglla, të njohur në këtë koleksion dhe në literaturën botërore si Avdo Megjedomiq dhe Salih Uglanin. Në kuadër të këtij koleksioni është edhe Koleksioni i këngëve shqipe i Allbert Llordit, me rreth njëzet mijë vargje të Eposit të Kreshnikëve, i shënuar më 1937, në Shqipërinë e Veriut, dy vjet pas vdekjes së M. Perit.

Prandaj, kjo paraqitje ishte me interes të veçantë, sepse Eposi i Kreshnikëve ende e vazhdon jetën e vet, që nga gjysma e dytë e mijëvjeçarit të parë e deri në fillim të këtij mijëvjeçari të tretë, si dhe ai bashkëjeton me epikën tonë historike që nga viti 1389, pra nga cikli i Betejës së Kosovës e deri te cikli i tashëm i UÇK-së.

Në punimet e simpoziumit kanë qenë të pranishëm edhe profesorë dhe studentë të Departamentit të Folklorit dhe të Mitologjisë të Universitetit të Harvardit, drejtuesit e Koleksionit të M. Perit, prof. Stephen Mitchell (Stiven Miçell) dhe Gregory Nagy (Gregori Naxh), si dhe pasardhës të Perit e të Llordit: Marian Parry, Nate Lord etj. Do të përmendja edhe praninë e rapsodit

Shaban Lajçi, i veshur kombëtarisht, që zgjoi interesim, sidomos gjatë pauzave, për bisedë dhe për t'u fotografuar.

Prania jonë në këtë tubim shkencor botëror, jashtëzakonisht të rëndësishëm, në Universitetin e Harvardit, në shkollën më elitare në SHBA dhe në botë, men-

doj, është nder i madh për epikologjinë dhe për studimet albanologjike.

Me këtë rast, falënderoj Ministrinë e Shkencës (MASHT) për ndihmën financiare, për shpenzimet e fjetjes (tri net në Kembrixh), si dhe Ministrinë e Kulturës (MKRS) për biletë (Prishtinë-Boston). ■

Jetëshkrimi

Profesor Zymer Neziri është lindur më 6 nëntor të vitit 1946, në Siparant, ose Zahaq të Pejës, krahina e Rugovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Pejë, më

1960, ndërsa shkollën e mesme të përgjithshme e kreu në Pejë, më 1964. Shkollën normale e kreu në Prishtinë, më 1966. Ka kryer studimet në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren, më 1969 dhe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, më 1971. Në atë fakultet, gjatë viteve 1972-1974, ndoqi edhe mësimet e studimeve të shkallës së tretë në Degën e Letërsisë dhe mbrojti magjistraturën me temën «Figura e krahasimit në këngët tona lirike të dashurisë» (1979). Pas shumë vitesh pengesash politike, po aty mbrojti doktoratën me temën «Poezia legjendare e Rugovës» (1995). Më 1971, pas mbarimit të studimeve themelore, u pranua asistent në Degën e Folklorit dhe të Etnologjisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, nga e cila, në vitin 1973 e përjashtuan, me vendim të organeve politike të Kosovës, për shkak të veprimtarisë së tij në Lëvizjen studentore të vitit 1968. Nga viti 1967 merret me vjeljen e folklorit, ndërsa njësitë e tij janë botuar në disa vëllime të IAP-it. Në krahinën e Rugovës mbledhi poezinë epike legjendare (1979-1988) dhe projektin e realizoi me vetëfinancim, material që përmban 15 vëllime të veçanta dhe që vlerësohet ndër koleksionet më të mëdha arkivore me këngë të Eposit të Kreshnikëve. Është mbledhës edhe i epikës historike. Vazhdon punën e hulumtimit dhe të mbledhjes së folklorit edhe në Republikën e Shqipërisë dhe në Mal të Zi.

Përveç punës hulumtuese të disahershme në arkivat e Tiranës, ka realizuar edhe dy qëndrime studimore në SHBA, në Universitetin e Harvardit dhe një në Austri, në Vjenë. Në Harvard, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, ka bërë hulumtime në Koleksionin e profesorit amerikan Millmen Peri (Milman Parry) për epikën gojore shqiptare, të mbledhur dhe të incizuar më 1934-1935 në pjesën veriore të Vilajetit të Kosovës, në Sanxhakun e Pazarit. Ky Koleksion vlerësohet në SHBA si më i madhi i këtij lloji nga Ballkani Perëndimor, për të cilin janë shkruar disa dhjetëra disertacione doktoratash dhe studime të tjera. Po ashtu, ka hulumtuar edhe në Koleksionin e ndihmësit të tij, Allbert Llord (Albert Lord), këngë epike nga Shqipëria e Veriut, të shënuara më 1937. Edhe ky koleksion, me rreth 20 mijë vargje të Eposit të Kreshnikëve, vlerësohet se është më i madhi i këtij lloji i mbledhur nga një i huaj. Në Vjenë, ka realizuar projektin «Dorëshkrimet shqip të folklorit të Maksimilian Lambercit (Maximilian Lambertz), në Akademinë e Shkencave të Austrisë-Arkivi, si dhe në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë-Dorëshkrime, Autografe dhe Koleksion Trashëgimie. Ka shikuar dhe ka analizuar dorëshkrimet e Lambercit në rreth 60 dosje: folklor, folkloristikë, mitologji, etnologji, gjuhësi, letërsi, histori etj. Nga viti 1969 publikoi mbi 350 zëra bibliografikë për folklorin, letërsinë, etnologjinë, historinë etj., ndonëse për shumë vite iu censuruan punimet e tij. Studime dhe artikuj për letërsinë gojore botoi në: «Gjurmime albanologjike» (Prishtinë), «Kultura popullore» (Tiranë), «Çështje të folklorit shqiptar» (Tiranë), «Seminarin Ndërkombëtar...» (Prishtinë), dhe në organe të tjera shkencore dhe informative brenda e jashtë vendit (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Rumani, Itali).

Ka marrë pjesë me kumtesa, kryesisht nga fusha e studimit të epikës sonë gojore, në shumë tubime shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, brenda e jashtë vendit (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Poloni, Bosnjë e Hercegovinë, SHBA).

Është bashkërealizues i projektit ndërkombëtar në Harvard (2003-2007) për përgatitjen e këngëve epike shqipe, të mbledhura nga profesori i Harvardit, Allbert Llord (Albert Lord). Në ekipin realizues të projektit janë edhe profesorët David Elmer (Universiteti i Harvardit), Nicola Scaldaferrri (Universiteti i Milanos) dhe John Kost (Universiteti i Teksasit në Austin).

VËLLEZËRIT KLITSCHKO NUK E LËNË T'I “MBYLLË SYTË”

Alban BILALLI

Boksieri shqiptar nga Juniku, Luan Krasniqi, do të rikthehet sërish në ring në moshën 39-vjeçare. Krasniqi do të ketë si kundërshtar amerikanin 28-vjeçar Johnathon Banks. Në rast të fitores, Krasniqit mund t'i ofrohet mundësia që të sfidojë Vitaly Klitschkon për titullin WBC të peshës së rëndë ose Vladimir Klitschkon për titujt e botës të versioneve IBF, WBO e IBO.

Vetë Krasniqi është shprehur se ndihet mjaft i lumtur që po i jepet mundësia e kthimit të sërishëm në ring për të fituar një rast në përballje titanësh me Klitschkot. Por para se ta fitojë këtë rast, ai duhet t'ia “thyejë hundët” amerikanit Johnathon Banks. Luan Krasniqi është shprehur se dëshira e tij është që të ndeshet me njërin nga vëllezërit Klitschko. “E vetmja gjë që më kthen në ring është mundësia për një përballje me Klitschkot. Kjo është ëndrra ime”, - ka thënë Krasniqi për “Hamburger Abendblatt”.

Pos dëshirës për t'u ndeshur me Klitschkot, Krasniqi është shprehur se ai mund të jetë gjermani i parë që ka fituar titullin e botës pas të famshmit Max Schmelingut.

“Mund të jem ende boksieri i parë gjerman që ka fituar titullin e botës në peshat e rënda, pas Max Schmelingut”, - ka thënë Krasniqi. Ai madje për mediat gjermane ka thënë se ka mjaft besim për ta arritur këtë qëllim.

“E di se sa i rrezikshëm është boksi dhe nuk do të isha rikthyer sikur të mos kisha besim se do ta fitoja titullin e botës”.

I pyetur nga mediat gjermane se me cilin nga vëllezërit Klitschko do të dëshironte të përballlej, Luani ka preferuar Vitalin. “Mendoj se do të boksoj kundër Vitalyt”, - ka thënë Krasniqi. Për Luan Krasniqin kjo nuk është hera e parë që lufton për titullin e botës, ngase ai pat luftuar për versionin WBO, por që mposhtur nga boksieri amerikan Lamon Brewster me nokaut teknik në raundin e nëntë.

Luani rikthehet në ring pas një pauze afro dyvjeçare. Luani duelin e fundit e zhvilloi më 15 nëntor të vitit 2008, ku pësoi nokaut në raundin e tretë nga ukrainasi Alexander Dimitrenko. Ai, në boksin profesionist, ka 30 fitore (14 KO), katër humbje dhe një barazim. ■

“E vetmja gjë që më kthen në ring është mundësia për një përballje me Klitschkot. Kjo është ëndrra ime”, - ka thënë Luan Krasniqi, boksieri më i madh shqiptar i të gjitha kohërave.



BARCELONA TRANSFEROI EDHE NJË FUTBOLLIST MUSLIMAN

Edhe një musliman në klubin e Barcelonës. Pas Keitës dhe Abidalit, tani grupit të muslimanëve në klubin katalan i shtohet edhe Afellay. Prezantimi në Barcelonë i befasoi të pranishmit në stadium. Ai doli me prindërit, ku nëna e tij mbante shami në kokë, duke treguar se ai dhe familja e tij kanë besim islam.

Alban BILALLI

Barcelona në muajin janar jo vetëm që transferoi njërin nga talentet më të mëdha në botën e futbollit, por ajo transferoi në radhët e veta një musliman të devotshëm. Është fjala për 24 vjeçarin Ibrahim Afellay. I lindur në Holandë, me prindër me prejardhje nga Maroku, Afellay, pos talentit të madh si futbollist, është i njohur edhe si besimtar i devotshëm. Është praktikues i obligimeve islame. Madje kur shënon gol, ai i ngre të dy duart nga qielli në shenjë falënderimi për Allahun që i mundësoi të shënojë gol. Është lexues i rregullt i Kuranit dhe gjatë gjithë ndeshjes përsërit fjalë në shenjë falënderimi për Allahun. Tani, Afellay, prej këtij muaji, do të luajë në klubin më të mirë të botës, Barcelonën, e cila njihet për lojën e saj të shkëlqyer që të lë pa koment. Do të jetë nën urdhrat e Pep Guardiols, mjeshtrit të lojës së Barçës, që e kanë zili edhe regjisorët më

të njohur të Hollivudit. Në prezantimin që bëri në stadiumin e Barcelonës, në shtëpinë e tij të re, ishin të pranishëm edhe prindërit e tij muslimanë, babai dhe nëna me shami në kokë.

Për tifozët e Barcelonës prezantimi



i një futbollisti musliman në “Kamp Nou” nuk ishte surprizë, ngase në këtë “teatër” të futbollit kanë bërë karrierë edhe shumë futbollistë të njohur musliman si Henry, Jaja Ture, Erik Abidal, Seud Keita, etj. Por ajo që i la gojëhapur tifozët e Barçës ishte prezantimi i Afellayit me prindërit, ku nëna e tij ishte me shami në kokë, që tregoi se ai rrjedh nga një familje me traditë islame.

Futbollisti i vitit

Ibrahim Afellay llogaritet si njëri nga talentet më të mirë në botën e futbollit. Me prindër nga Maroku, ai është reprezentues holandez dhe në vitin 2007 u zgjodh futbollisti i vitit në Holandë. Ishte pjesëmarrës edhe në kampionatin e fundit botëror në Afrikën e Jugut.

Karrierën e filloi në disa skuadra të vogla në Holandë për t'u transferuar te klubi i madh holandez, kampioni i shumëfishhtë PSV Eindhoven. Barcelona është klubi i parë jashtë Holandës, klub me të cilin ka nënshkruar kontratë katërvjeçare. ■

Hapësirë për reklamim në revistë!

1/1
100€

1/2
50€

1/4
25€

Në vlerat e çmimeve nuk është përfshirë TVSH-ja

Studio për prodhimin e kuzhinave

kezza

5
VITE GARANCION


Prodhimet tona mund të blihen me kredi përmes **Raiffeisen Bank**

Made in Kosova

kkeza@hotmail.com

mob. +377 (0)44 141 909

tel & fax. +381 (0)38 243 863



Ky është libri i parë i autorit Sabri Halili, i cili flet për jetën dhe veprimtarinë inventive të Rifat Gjetës. Libri nxjerr në pah sfidat dhe vështirësitë që ka pasur zbuluesi Gjota në veprimtarinë e tij. Për autorin e librit ka qenë edhe një problem tjetër, sepse të shkruash për shkencë ekzakte, matematikë dhe rrymë nga një person që nuk është kompetent është vështirësi, por kur ta lexoni librin do ta shihni se Halili ia ka arritur me sukses.